URDHRI FRANÇESKAN SHEKULLAR

KUSHTETUTAT E PËRGJITHSHME
TË URDHRIT FRANÇESKAN SHEKULLAR

Romë, 2001

Kushtetutat e Përgjithshme të Urdhrit Françeskan Shekullar

Titilli i origjinalit në italisht:
REGOLA E COSTITUZIONI GENERALI
DELL'ORDINE FRANCESCANO SECOLARE

Përktheu:
Anonim

Korrektorë letrarë:
Nikolin Sh. Lëmezhi,
Kristian F. Gjokhilaj

Përgatitur nga Qendra për shtyp:
"Njeriu i Ripërtërirë"
Shkodër, Mars 2010

Qendra e botimeve "Njeriu i Ripërtërirë"
Lagjja "Tre Heronjtë"
Rruga "Revolucioni Antikomunist Hungarez", Nr. 1
Shkodër (Shqipëri-Albania)

CONGREGATIO PRO INSTITUTIS VITAE CONSACRATAE
ET SOCIETATIBUS VITAE APOSTOLICAE
Prot. nr. T. 144 –1/2000

DEKRET I KONGREGATËS PËR INSTITUTET E JETËS SË KUSHTUAR DHE SHOQËRITË E JETËS APOSTOLIKE

DEKRET

Konferenca e Ministrave të Përgjithshëm të Urdhrit të Parë Françeskan dhe të Urdhrit të Tretë Rregulltar, me miratim paraprak nga Kapitulli Gjeneral i Urdhrit Françeskan Shekullar, i kremtuar në muajin tetor të 1999-s, i ka paraqitur Selisë Apostolike tekstin e Kushtetutave të vetë Urdhrit Françeskan Shekullar, duke i kërkuar miratimin.

Kongregacioni për Institutet e Jetës së Kushtuar dhe Shoqëritë e Jetës Apostolike, pasi ka shqyrtuar me vëmendje tekstin e lartpërmendur të Kushtetutave, me dekretin e pranishëm *e miraton dhe e ripohon*, sipas ekzemplarit të redaktuar në gjuhën italiane, që ruhet në Arkivin e tij, i vëzhguar për sa i përket të drejtës që duhet të shqyrtohet.

Pa marrë parasysh çfarëdo dispozite në kundërshtim.

Vatikan, më 8 Dhjetor 2000, Dita e Kremtimit të Zojës së Papërlyer dhe të së Bekuarës Mari.

Edoardo Card. Martínez Somalo
Prefekt

+ Piergiorgio Silvano Nesti, C.P.
Sekretar

CONGREGATIO PRO INSTITUTIS VITAE CONSECRATAE
ET SOCIETATIBUS VITAE APOSTOLICAE
Prot. n. T. 144-1/2000

DECRETO DELLA CONGREGAZIONE PER GLI ISTITUTI DI VITA CONSACRATA E LE SOCIETÀ DI VITA APOSTOLICA

D E C R E T O

La Conferenza dei Ministri Generali del Primo Ordine Francescano e del Terz'Ordine Regolare, con previa approvazione del Capitolo Generale dell'Ordine Francescano Secolare, celebrato nel mese di ottobre 1999, ha presentato alla Sede Apostolica il testo delle Costituzioni del medesimo Ordine Francescano Secolare, chiedendone l'approvazione.

La Congregazione per gli Istituti di vita consacrata e le Società di vita apostolica, dopo aver attentamente esaminato il summenzionato testo delle Costituzioni, col presente Decreto *lo approva e lo conferma*, secondo l'esemplare redatto in lingua italiana, che si conserva nel suo Archivio, osservato quanto per diritto si deve osservare.

Nonostante qualsiasi disposizione in contrario.

Dal Vaticano 8 dicembre 2000, Solennità dell'Immacolata Concezione della Beata Vergine Maria.

Eduardo Card. Martínez Soma
Prefetto

+ Piergiorgio Silvano Nesti, C.P.
Segretario

DORËZIMI I KUSHTETUTAVE TË PËRGJITHSHME

Romë, më 1 janar 2001
Maria Tejet e Shenjtë Nëna e Hyjit

E dashur motër Manuela!
Zoti të dhuroftë paqe!

Kongregacioni për Institutet e Jetës së Kushtuar dhe Shoqëritë e Jetës Apostolike, me datën 8 dhjetor të vitit 2000, ka nxjerrë Dekretin (Prot. n. T. 144-1/2000) e miratimit të Kushtetutave të Përgjithshme të Urdhrit Françeskan Shekullar, kështu siç kanë qenë të korrigjuara në Kapitullin Gjeneral të UFSH-së të Madridit, në tetor të 1999-s, dhe më pas të paraqitura nga Presidenti i radhës i Konferencës së Ministrave të Përgjithshëm të Urdhrit të Parë Françeskan e të UFSH-së.

Tani, edhe në emër të Ministrave të tjerë të Përgjithshëm, të jap në mirëbesim tekstin e miratuar të Kushtetutave dhe, nëpërmjet teje, të gjithë Vëllezërve dhe Motrave të UFSH-së. Thirrja[1] e përbashkët e të gjithë Familjes Françeskane, duke u nisur nga përvoja shpirtërore e jashtëzakonshme e Françeskut dhe e Kjarës, është ajo e "të jetuarit sipas mënyrës së Ungjillit të shenjtë"; për të mishëruar këtë thirrje të pashembullt midis larmisë së pasur të shprehjeve të saj të ndryshme, në botën dhe në kohën në të cilën Zoti na e dërgon, Kushtetutat tregohen një ndihmë gjithnjë e më shumë e rëndësishme. Nuk bëhet fjalë për një "dokument më shumë", as për etapën përfundimtare të një udhëtimi, por për një instrument kryesor e dinamik, që ndihmon për të përkufizuar identitetin tonë dhe për të strukturuar në mënyrë përparuese jetën tonë dhe thirrjen tonë prej françeskanësh. Si puna e reflektimit dhe e rishikimit e kryer nga shumë Vëllezër e Motra nga e gjithë bota, dhe miratimi nga ana e Kishës Nënë, na angazhojnë të bëjmë në mënyrë që këto Kushtetuta të bëhen kriter shurdhues në të cilin të projektojmë ekzistencën tonë për të jetuar sipas mënyrës ungjillore.

Është ky urimi që ua bëj të gjithë Françeskanëve Shekullarë në emër të Kishës dhe të Ministrave të Përgjithshëm: të mundohen që të jenë dëshmimtarë të besueshëm të zjarrmisë ungjillore që ka ndezur ekzistencën e Françeskut dhe të Kjarës së Asizit dhe i ka bërë ata shembuj të një jete plotësisht të realizuar, sepse është plotësisht e dhuruar.

Në mënyrë vëllazërore,

Fra Giacomo Bini, ofm
Presidenti i radhës nga
Konferenca e Ministrave të Përgjithshëm
të Urdhrit të Parë e të UFSH-së



SHPALLJA E KUSHTETUTAVE TË PËRGJITHSHME

Romë, më 6 shkurt 2001
Qarkore 21/96-2
Këshillave kombëtare të UFSH-së
Këshillave ndërkombëtare të UFSH-së

Objektivi: Shpallja e Kushtetutave të Përgjithshme të korrigjuara dhe të miratuara me Dekretin e CIVCSVA, më 8 dhjetor të vitit 2000.

Të dashur!

Kushtetutat e Përgjithshme të Urdhrit Françeskan Shekullar, të caktuara për t'i dhënë zbatimin Rregullës së ripërtërirë të 1978-s, kanë qenë të miratuara nga Kongregacioni i Jetës së Kushtuar e i Shoqërive të Jetës Apostolike me Dekretin e 8 shtatorit të 1990-s, me vlerë për një gjashtëvjeçar, me qëllim për të qenë e mundur vënia në provë e tyre. Në kohën e duhur, Presidenca e CIOFS-së, nëpërmjet Konferencës së Ministrave të Përgjithshëm të Urdhrit të Parë e të UFSH-së, kërkoi zgjatjen e periudhës se eksperimentimit, duke marrë parasysh ndërprerjen që ishte e nevojshme për të vazhduar me përkthimin në gjuhët e tjera zyrtare të Vëllazërisë ndërkombëtare dhe, më vonë, në gjuhët e secilit nga shtetet. Kongregacioni përmbushi këtë kërkesë dhe dha një zgjatje afati për tre vjet.

Gjatë kësaj periudhe të kohës, Kushtetutat kanë qenë në studim dhe të vëna në zbatim nga Vëllazëritë e UFSH-së në të gjitha nivelet dhe, pak nga pak, ju kanë ngulitur karekteristikat e *shekullaritetit*, *njësimit dhe autonomisë* së Urdhrit tonë. Jo gjithçka ka qenë e lehtë dhe disa aspekte duhen akoma të jenë plotësisht të asimiluara me qëllim që, agimi i Mijëvjeçarit të Tretë, UFSH-ja të bëhet realisht "ushtri që mund të jetë në pararojën e Kishës dhe të botës për ndërtimin e një shoqërie sa më njerëzore dhe më të krishterë", siç uronte në 1990-n Kard. Hamer, Prefekti i Kongregacionit IVCSVA.

Nga vënia në provë kishte dalë në pah vlerësimi thelbësor i Kushtetutave të Përgjithshme të 1990-s dhe vetëm disa nga aspektet tregoheshin të nevojshëm për rishikim. Puna në rastin e nevojshëm është filluar në kohën e duhur nga Presidenca e CIOFS-së dhe është zhvilluar nëpërmjet një konsultimi të bollshëm, që ka përfshirë të gjitha Vëllazëritë kombëtare dhe Këshilltarët ndërkombëtarë, përveç edhe vetë Presidencës dhe disa nga ekspertët pjesmarrës në UFSH ose të shënuar nga Ministrat e Përgjithshëm Françeskanë.

Në Kapitullin e Përgjithshëm të Madridit (23-31 tetor 1999) është vënë nën shqyrtim teksti që përmblidhte, duke i koordinuar, këshillimet edhe kërkesat e

mbërritura, duke paraqitur edhe propozime alternative atje ku nuk kishte qenë e mundur të gjendej një formulim i njëkuptimshëm midis atyre që Vëllazëritë kombëtare kishin vënë përpara. Teksti i paraqitur në Kapitull frymëzohet nga kriteret e mëtejshme:

-- hyrje në të drejtën e përgjithshme dhe në të drejtën përkatëse të UFSH-së;

-- respekt për tekstin e miratuar në 1990 nga Selia e Shenjtë;

-- zhdërvjelltësi organizuese;

-- përshtatshmëri kulturore dhe gjuhësore.

Kapitulli i Përgjithshëm i ka dedikuar një shqyrtim të kujdesshëm e të përthelluar tekstit të nënshtruar edhe nga ndërhyrjet e prodhuara, me zë ose me shkrim, gjatë punimeve të Kapitullit.

Rezultati i debateve dhe i votimeve, të kryera nen për nen dhe korrektimet e secilit prej tyre, ka qenë i paraqitur me 21 dhjetor të 1999-s në Konferencën e Ministrave të Përgjithshëm françeskanë që, pas një verifikimi të mëtejshëm nën kujdesin e kanonistave të të katër Kurieve, e ka dërguar më 1 gusht të vitit 2000 në CIVCSVA për miratim. Kjo e fundit e ka miratuar me Dekretin përkatës, që mban datën e 8 dhjetorit të vitit 2000, dita e kremtimit të Zojës së Papërlyer e të Bekuarës Mari.

Tani, vëllezër e motra të UFSH-së, më 6 shkurt të vitit 2001 shpallen Kushtetutat e Përgjithshme të miratuara, që si rrjedhim do të duhen të respektohen duke filluar nga 6 marsi i vitit 2001. I përket çdonjërit nga ne të bëjë që të bëhen me të vërtetë "shpirt dhe jetë", instrument i përforcimit dhe i rritjes së Urdhrit tonë për të marrë gjerësisht ("Duc in altum!"), për të ecur përpara me shpresë, sipas thirrjes së drejtuar nga Ati i Shenjë të gjithë të krishterëve me anën e Letrës Apostolike "Fillimi i Mijëvjeçarit të Ri" në përfundimin e Jubileut të Madh të vitit 2000. Edhe ne françeskanët shekullarë jemi të thirrur për të qenë dëshmitarë, domethënë, martirë, në kuptimin origjinal të fjalës, të Krishtit, në Mijëvjeçarin e ri.

Jo rastësisht kemi zgjedhur datën 6 shkurt për shpalljen e Kushtetutave të Përgjithshme të korrigjuara. Kjo është data në të cilën përkujtohen Martirët e Parë, dëshmitarë për shkëlqimin e tyre, të Japonisë, dhe kështu 17 françeskanët e Urdhrit të Tretë të kryqëzuar në Nagasaki së bashku me Pedro Batista, me Paolo Miki dhe me shokë të tjerë të tyre. Dimë shumë pak për këta vëllezërit tanë të largët, mosheqja dorë nga vullneti për të qëndruar të fortë në besimin fetar, mostërheqja as e jetës së tyre nga dëshmia e Ungjillit, për çfarëdo lloj çmimi.

Edhe në shekullin e fundit kanë ekzistuar laikë françeskanë që kanë treguar, deri me flijimin e jetës, besnikërinë ndaj Pagëzimit dhe qëndresën ndaj së keqes, lidhjen e fortë ndaj fesë. Kujtojmë bashkëvëllain tonë Ceferino Giménez Malla, viktimë e përndjekjes kundër fesë gjatë Luftës Civile në Spanjë (1936 – 1939), që është shpallur "I Lum" më 4 maj 1997. Kujtojmë Shërbëtorin e Hyjit Frantisek Nosek, politikan bohem dhe françeskan shekullar, viktimë tjetër e dhunës komuniste. Kujtojmë Juvénal Kabera, Ministri i Vëllazerisë së UFSH-së i Kigalit, i

masakruar gjatë masakrave të Luftës Tribale në Rwanda. Këta janë vetëm disa nga shembujt, por vlen edhe për ata kur Ati i Shenjtë, kohët e fundit, ka deklaruar: "Mbi të gjitha ka qenë se falë dëshmisë së guximshme të besimtarëve laikë, jo rrallë deri në martirizim, që feja nuk është shuar nga jeta e popujve të tërë".

Ndoshta neve nuk do të na kërkohet martirizimi me gjak, por sigurisht na kërkohet dëshmia e koherencës dhe vendosmëria në përmbushjen e premtimeve të Pagëzimit, të ripërtërira dhe të ripohuara me Kushtet në UFSH. Në bazë të Kushteve, Rregulla dhe zbatimi që i bëjnë Kushtetutat e Përgjithshme duhet të paraqesin, për çdonjërin nga ne, pikën e referimit në përvojën e përditshme, duke u nisur nga një **thirrje** e përcaktuar dhe nga një **identitet** i përcaktuar mirë. Mbi këtë bazë duhet të ripunohet ekzistenca jonë dhe të gjendet një projekt i jetës (rrënjosja ungjillore françeskane) dhe një vend i bashkësisë kishtare (Vëllazëria), në të cilat të jetë i mundur leximi i "Përse dhe si të jetoj, të dua dhe të vuaj" (CC. GG. Neni 10).

Ky është urimi me të cilin Presidenca e CIOFS-së, mori Kushtetutat e Përgjithshme të miratuara, i përhap në tërë Urdhrin sepse, po ashtu si dhe Rregulla, të jenë të studiuara, të duhen, e të jetohen.

Emanuela De Nunzio
Ministre e Përgjithshme e UFSH-së

KUSHTETUTAT E PËRGJITHSHME

TË URDHRIT FRANÇESKAN SHEKULLAR

Kapitulli i parë

URDHRI FRANÇESKAN SHEKULLAR

Neni 1

1. Të gjithë besimtarët janë të thirrur në shenjtërim dhe kanë të drejtë të ndjekin, duke qenë në bashkësi me Kishën, një udhëtim shpirtëror përkatës.
2. Në Kishë ekzistojnë shumë familje shpirtërore, që ndryshojnë nga karizmat[1]. Midis këtyre familjeve shquhet Familja Françeskane që, në degëzimet e saj të ndryshme, njeh si atë, frymëzues dhe shembull, shën Françeskun e Asizit (krh. *Rreg.* 2).
3. Që në kohët e para të fillimit, Urdhri Françeskan Shekullar ka një vend të përcaktuar në Familjen Françeskane. Ai është i formuar nga bashkimi organik i të gjitha Vëllazërive katolike, anëtarët e së cilës, të vënë në lëvizje nga Shpirti Shenjt, detyrohen me Kushtet për të jetuar Ungjillin sipas mënyrës së Françeskut në gjendjen e tyre shekullare, duke ndjekur Rregullën e miratuar nga Kisha (krh. *Rreg.* 2).
4. Në bazë të virtytit të anëtarësisë në të njëjtën familje shpirtërore, Selia e Shenjtë ia ka besuar kujdesin baritor dhe ndihmesën shpirtërore të UFSH-së Urdhrit të Parë Françeskan dhe Urdhrit të Tretë të Rregullt (TOR). Ato janë "Institutet" të cilave i përket "altius moderamen" në lidhje me Kan. 303.
5. Urdhri Françeskan Shekullar (UFSH) është në Kishë një shoqatë publike. Përbëhet nga Vëllazëri në nivele të ndryshme: lokale, krahinore, kombëtare dhe ndërkombëtare. Secila nga ato ka në veçanti personalitet juridik në Kishë.

Neni 2

1. Thirrja e UFSH-së është një thirrje e përcaktur, që formon jetën dhe veprën apostolike të anëtarëve të tij. Për këtë arsye nuk mund të bëjnë pjesë në UFSH ata që janë të lidhur, nëpërmjet një angazhimi të përjetshëm, ndaj një familjeje tjetër rregulltare ose një instituti jete të përkushtuar.
2. UFSH-ja është e hapur ndaj besimtarëve të çdo pozicioni shoqëror. Në të mund të bëjnë pjesë:

- laikët (burra e gra);

[1] Karizëm është hir, dhuratë, që vjen prej Shpirtit Shenjt. Kur flasim për karizma të ndryshme nënkuptojmë atë larmi dhuratash që Shpirti i Hyjit, pra, i jep secilit person e secilës bashkësi në Kishë, për rritjen personale e të përbashkët. Prandaj, siç thotë edhe shën Pjetri, "shërbeni njëri-tjetrit, secili sipas dhuratës që keni marrë, si mbarështues të mirë të hirit të shumëllojshëm të Hyjit". Kur të themi "karizëm" në numrin njëjës, normalisht nënkuptojmë atë hir specifik dhe përkatës që dallon një Institut prej një tjetri. [shënim i korrektorëve letrarë].

- klerikët shekullarë (diakonj, priftërinj, ipeshkvij).

Neni 3

1. Natyra shekullare shquan karakterin shpirtëror dhe jetën apostolike të pjesëmarrësve në UFSH-së.
2. Shekullariteti i tyre, në thirrjen dhe në jetën apostolike, shprehet sipas kushtit përkatës, kështu që:

- për laikët, duke ndihmuar në ndërtimin e Mbretërisë së Hyjit me praninë e tyre në realitetin dhe në aktivitetet kohore;
- për priftërinjtë shekullarë, duke i dhënë Popullit të Zotit shërbimin e tyre personal, së bashku me ipeshkvin dhe me meshtarin.

Si laikët dhe klerikët të frymëzohen nga pjesët ungjillore të shën Françeskut të Asizit, duke u angazhuar për të vazhduar misionin e tij së bashku me përbërësit e tjerë të Familjes Françeskane.
3. Thirrja e UFSH-së është thirrje për të jetuar Ungjillin në bashkësi vëllazërore. Për këtë qëllim, anëtarët e UFSH-së mblidhen në bashkësi kishtare që quhen Vëllazëri.

Neni 4

1. UFSH-ja është e ngritur nga e drejta universale e Kishës dhe nga vetë: Rregulla, Kushtetutat, Rituali dhe Statutet e veçanta.
2. Rregulla vendos natyrën, qëllimin dhe shpirtin e UFSH-së.
3. Kushtetutat kanë si qëllim:

- të zbatojnë Rregullën;
- të tregojnë konkretisht kushtet e pjesëmarrjes në UFSH, regjimin i tij, organizimin e jetës së vëllazërisë, selinë (krh. *Rreg.* 3).

Neni 5

1. Interpretimi autentik i Rregullës dhe i Kushtetutave i përket Selisë së Shenjtë. (krh. *Rreg.* 3).
2. Interpretimi praktik i Kushtetutave, me qëllimin që të harmonizojë zbatimin në zonat e ndryshme dhe në nivele të ndryshme të Urdhrit, i përket Kapitullit të Përgjithshëm të UFSH-së.
3. Sqarimi i pikave të veçanta, që kërkojnë një vendim të shpejtë, është nën kompetencën e Kryesisë së Këshillit Ndërkombëtar të UFSH-së (CIOFS-së). Ky sqarim ka vlerë deri në Kapitullin e ardhshëm të Përgjithshëm.

Neni 6

1. Vëllazëria ndërkombëtare e UFSH-së ka një Statut përkatës të miratuar nga Kapitulli i Përgjithshëm.
2. Vëllazëritë kombëtare kanë Statutet e tyre përkatese të miratuara nga Presidenca e CIOFS-së.
3. Vëllazëritë krahinore dhe lokale mund të kenë Statutin përkatës të miratuar nga Këshilli i nivelit më të lartë.

Neni 7

Të gjitha vendimet që nuk përkojnë me Kushtetutat e pranishme janë të shfuqizuara.

Kapitulli i dytë

FORMA E JETËS DHE AKTIVITETI APOSTOLIK

Titulli I

FORMA E JETËS

Neni 8

1. Françeskanët shekullarë angazhohen me Kushtet për të jetuar Ungjillin në gjendjen e tyre shekullare në përputhje me karakterin shpirtëror françeskan.
2. Përpiqen të thellojnë, nën ndriçimin e fesë, vlerat dhe zgjedhjet e jetesës ungjillore sipas Rregullës së UFSH-së:

- në një itinerar vazhdimisht të ripërtërirë shndërrimi[2] dhe formimi; (krh. *Rreg.* 7).
- të hapur ndaj kërkesave që vijnë nga shoqëria dhe nga realitetet kishtare, duke kaluar nga Ungjilli në jetë dhe nga jeta në Ungjill; (krh. *Rreg.* 3).
- në përmasën personale dhe të bashkësisë së këtij itinerari.

Neni 9

1. Karakteri shpirtëror i françeskanit shekullar është një projekt i jetës i përqendruar mbi personin e Krishtit dhe mbi ndjekjen[3] e tij, më mirë se një program i hollësishëm për ta vënë në zbatim. (krh. *Rreg.* 5).

2. Françeskani shekullar, i angazhuar për të ndjekur shembullin dhe mësimet e Krishtit, ka për detyrë të studiojë personalisht e me zell Ungjillin dhe Shkrimin Shenjt. Vëllazëria dhe përgjegjësat e saj të nxisin dashurinë ndaj Fjalës ungjillore e të ndihmojnë vëllezërit, me ndihmën e Shpirtit, për ta njohur e per ta pushtuar në të njëjtën mënyrë ashtu si ajo është e shpallur nga Kisha. (krh. *Rreg.* 4).

Neni 10

"Krishti i varfër dhe i kryqëzuar", fitimtar i vdekjes dhe i ringjallur, është shfaqja më e lartë e dashurisë së Zotit ndaj njeriut, është "libri" në të cilin vëllezërit, sipas imitimit të Françeskut, mësojnë "përse dhe mënyrën si të jetojnë, të duan dhe të vuajnë". Tek Ai zbulojnë vlerën e kontradiktave për shkak të drejtësisë dhe ndjesinë e vështirësive dhe të halleve të jetës së përditshme. Së bashku me Të ata munden të pranojnë vullnetin e Atit edhe në rrethanat më të vështira dhe të jetojnë shpirtin françeskan të paqes, me refuzimin e çdo doktrine që është në kundërshtim me dinjitetin e njeriut. (krh. *Rreg.* 10).

Neni 11

Mirënjohës që Shpirti Shenjt është burimi i thirrjes së tyre, frymëzuesi i jetës vëllazërore dhe i misionit, françeskanët shekullarë të përpiqen të imitojnë besnikërinë e Françeskut në frymëzimet e tij dhe të dëgjojnë këshillimin e Shenjtit për të dëshiruar mbi të gjitha "Shpirtin e Zotit dhe veprat e tij".

Neni 12

1. Duke u frymëzuar nga shembulli dhe shkrimet e Françeskut, e mbi të gjitha me hirin e Shpirtit, vëllezërit të jetojnë çdo ditë me bindje fetare dhuratën e madhe që na ka bërë Krishti: zbulesën e Atit. Të bëhen dëshmim i kësaj feje përballë njerëzve:

- në jetën e familjes;
- në punë;
- në gëzim dhe në vuajtje;
- në takimin me njerëzit, të gjithë vëllezër, me të njëjtin Atë;
- me praninë dhe pjesëmarrjen në jetën shoqërore;
- në raportin vëllazëror me të gjitha qeniet e krijuara.

2. Me Jezusin, i bindur deri në vdekje, të përpiqen të njohin e të bëjnë vullnetin e Atit. Të falënderojnë Zotin që na ka dhënë për dhuratë lirinë e për zbulimin e ligjit të

dashurisë. Të pranojnë ndihmën që, për të kryer vullnetin e Atit, atyre i vjen e ofruar nga ndërmjetësimi i Kishës, si nga ata që kanë qenë të emëruar tek ajo në pushtet, si dhe nga bashkëvëllezërit. Të marrin përsipër me vendosmëri të kthjellët rrezikimin kur bëjnë zgjedhje të guximshme në jetën shoqërore. (krh. *Rreg.* 10).
3. Vëllezërit të duan takimin birnor me Zotin dhe ta kenë lutjen dhe soditjen shpirtin e të qenurit të tyre e të veprimit të tyre. Të përpiqen të zbulojnë praninë e Atit në zemrën e tyre, në natyrën dhe në historinë e njerëzimit, në të cilën kryhet projekti i tij shpëtimtar. Soditja e këtij misteri do t'i bëjë ata të gatshëm për të bashkëpunuar në këtë projekt dashurie. (krh. *Rreg.* 8).

Neni 13

1. Françeskanët shekullarë, në kohët e lashta quheshin "vëllezërit e motrat e pendesës", paraqiten për të jetuar në shpirtin e shndërrimit të përhershëm. Mjetet për të kultivuar këtë veçori të thirrjes françeskane, në mënyrë individuale dhe në Vëllazëri, janë: dëgjimi dhe kremtimi i Fjalës së Hyjit, rishikimi i jetës, tërheqjet në vetmi shpirtërore, ndihma e një këshilltari shpirtëror dhe kremtimet pendestare. T'i afrohen sa më shpesh sakramentit të Pajtimit dhe të kujdesen për kremtimin e përbashkët, si në Vëllazëri po ashtu dhe me të gjithë Popullin e Zotit. (krh. *Rreg.* 7).
2. Mbi këtë bazë shpirtërore të shndërrimit jetohet dashuria në ripërtëritjen e Kishës, për ta shoqëruar me ripërtëritjen personale dhe të bashkësisë. Fryt i shndërrimit, që është një përgjigje ndaj dashurisë së Zotit, janë veprat e mirësisë në drejtim të vëllezërve.
3. Praktikat e pendesës si agjërimi dhe kreshmimi, traditë midis pendestarëve françeskanë, duhet të njihen, të vlerësohen e të jetohen sipas udhëzimeve të përgjithshme të Kishës.

Neni 14

1. Të vetëdijshëm që Zoti ka dashur të bëjë me të gjithë ne një popull dhe që ka themeluar Kishën e tij si sakrament universal të shpëtimit, vëllezërit të angazhohen për një reflektim fetar mbi Kishën, mbi misionin e saj në botën e sotme dhe mbi rolin e laikëve françeskanë në të, duke mbledhur sfidat dhe duke marrë përgjegjësitë që ky reflektim do të bëj ata të zbulojnë.
2. Eukaristia është qendra e jetës së Kishës. Në të Krishti na bashkon me veten e Tij dhe midis nesh si një trup i vetem. Rrjedh që, Eukaristia është qendra e jetës së Vëllazërisë; vëllezërit të marrin pjesë në Eukaristi sa më shpesh që të jetë e mundur, mirënjohës të respektit dhe të dashurisë së Françeskut që në Eukaristi ka jetuar të gjitha misteret e jetës së Krishtit. (krh. *Rreg.* 8).
3. Të marrin pjesë në sakramentet e Kishës, të jenë të kujdesshëm jo vetëm në shenjtërimin përsonal por edhe për të shërbyer në rritjen e Kishës dhe në zmadhimin e

Mbretërisë. Të bashkëpunojnë në celebrimin plot jetë e të vetëdijshëm në famullitë e tyre, veçanërisht në celebrimin e pagëzimit, e krezmimit, e martesës dhe të vajimit të të sëmurëve.
4. Vëllezërit dhe Vëllazëritë të kujdesohen në udhëzimin e Ritualit përsa i përket formave të ndryshme për tu shoqërizuar në lutjen liturgjike të Kishës, duke i dhënë përparësi celebrimit të Liturgjisë së Orëve.
5. Në çdo vend e në çdo kohë është e mundur për adhuruesit e vërtetë të Atit t'ia bëjnë kultin e t'a lusin; gjithashtu vëllezërit të kërkojnë të gjejnë kohët e heshtjes dhe të përqendrimit për t'ia dedikuar vetëm lutjes.

Neni 15

1. Françeskanët shekullarë të angazhohen për të jetuar shpirtin e Lumturive Ungjillore dhe në mënyrë të veçantë shpirtin e varfërisë. Varfëria ungjillore shfaq besimin në Atin, zbaton lirinë shpirtërore dhe ka mundësi për të nxitur një shpërndarje më të drejtë të pasurive. (krh. *Rreg.* 11).
2. Françeskanët shekullarë, që me anë të punës dhe të të mirave materiale duhet të kujdesen për familjen e tyre dhe ti shërbejnë shoqërisë, kanë një mënyrë të veçantë për të jetuar varfërinë ungjillore. Për t'a kuptuar dhe për t'a zbatuar kërkohet një angazhim i vërtetë përsonal dhe nxitja e Vëllazërisë nëpërmjet lutjes dhe dialogut, rishikimi në kompleksitet i jetës, dëgjimi i udhëzimeve të Kishës dhe të istancave të shoqërisë.
3. Françeskanët shekullarë të angazhohen për të pakësuar pretendimet e tyre përsonale për të mundur sa më mirë të ndajë të mirat shpirtërore dhe materiale me vëllezërit, mbi të gjitha me këta të fundit. Të falënderojnë Zotin për të mirat e dhëna, duke i përdorur si administrues të mirë dhe jo si pronarë.
Të marrin me vendosmëri qendrimin kundër konsumizmit dhe kundër ideologjive e praktikave që vënë në kundërshtim pasurinë ndaj vlerave njerëzore e fetare dhe që lejojnë shfrytëzimin e njeriut.
4. Të duan dhe të zbatojnë dëlirësinë e zemrës, burimi i vëllazërisë së vërtetë.

Neni 16

1. Maria, nëna e Jezusit, është shembull në dëgjimin e Fjalës dhe në besnikërinë e thirrjes: tek Ajo, si Françesku, shohim të realizuara të gjitha virtytet ungjillore. (krh. *Rreg.* 9).
Vëllazëritë të kultivojnë dashurinë e thellë ndaj Zojës së Bekuar, imitimin, lutjen dhe braktisjen birnore. Të shfaqin devotshmërinë e tyre me shprehje të fesë autentike nëpërmjet formave të pranuara nga Kisha.
2. Maria është shembull i dashurisë së frytshme dhe besnike për të gjithë bashkësinë kishtare.

Françeskanët Shekullarë dhe Vëllazëritë të kërkojnë për të jetuar eksperiencën e Françeskut, që bëri Zojën udhëheqëse të veprës së tij; me të, si nxënësit në ditën e Rrëshajëve, të mirëpresin Shpirtin për t'u realizuar në bashkësi dashurie.

Titulli i II

PRANIA AKTIVE NË KISHË E NË BOTË

Neni 17

1. Të thirrur për të bashkëpunuar në ndërtimin e Kishës, si sakrament i shpëtimit për të gjithë njerëzit dhe nëpërmjet pagëzimit dhe Kushteve bëhen "dëshmimtarë dhe instrumente të misionit të tij", françeskanët shekullarë bëjnë të njohur Krishtin me vepra dhe me fjalë (krh. *Rreg.* 6).
Apostullimi i tyre i preferuar është dëshmimi i vetvetës në mjedesin në të cilin jetojnë dhe shërbimi në ndërtimin e mbretërisë së Zotit në realitetet tokësore.
2. Në Vëllazëri të nxitet përgatitja e vëllezërve në përhapjen e mesazhit ungjillor " në kushtet e zakonshme të shekullit" dhe në bashkëpunimin për katekizmin në bashkësitë kishtare.
3. Ata që janë thirrur për të zhvilluar misionin e katekistave, të drejtuesve të bashkësive kishtare ose të ministrave të tjerë, për më tepër ministrat kishtarë, ta bëjnë të tyren dashurinë e Françeskut ndaj Fjalës së Zotit, besimin fetar të tij tek ata që e njohin dhe dëshirën e madhe me të cilën ai ka marrë nga Papa misionin e predikimit të pendesës.
4. Pjesëmarrja në shërbimin e shenjtërimit, që Kisha ushtron nëpërmjet liturgjisë, lutjes dhe veprave të pendesës e të mëshirës, vihet në zbatim nga vëllezërit mbi të gjitha në familjen e tyre, pastaj në Vëllazëri dhe së fundi me praninë e tyre aktive në Kishën lokale dhe në shoqëri.

Për një shoqëri të drejtë e vëllazërore

Neni 18

1. Françeskanët shekullarë janë të thirrur për të ofruar një kontribut të vetin, të frymëzuar ndaj personit dhe ndaj mesazhit të shën Françeskut të Asizit, ndaj një qytetërimi në të cilin dinjiteti i personit njerëzor, bashkëpërgjegjësia dhe dashuria të jenë realitete jetësore.

2. Duhet të thellojnë themelet e vërteta të vëllazërisë universale dhe të krijojnë kudo shpirt të mikpritjes dhe atmosferë të vëllazërimit. Të angazhohen me vendosmëri kundër çdo lloj forme të shfrytëzimit, te diskriminimit e të mënjanimit dhe kundër çdo mënyre sjelljeje të indiferencës ndaj të tjerëve (krh. *Rreg.* 13).
3. Të bashkëpunojnë me lëvizjet që nxisin vëllazërimin midis popujve: të angazhohen për të "krijuar kushte të denja të jetës" për të gjithë dhe për të punuar për lirinë e çdo populli (krh. *Rreg. 1*3).
4. Duke ndjekur shembullin e Françeskut, pajtor i ekologjistëve, të nxisin aktivisht nismat për ruatjen e qenies së krijuar, duke bashkëpunuar ndaj përpjekjeve për të shmangur degradimin e natyrës, dhe për të krijuar kushte të jetës dhe të mjedisit që të mos jenë të rrezikshme për njeriun.

Neni 19

1. Françeskanët shekullarë të veprojnë gjithmonë si tharm në mjedisin në të cilin jetojnë nëpërmjet dëshmimit të dashurisë vëllazërore dhe të motivimeve të qarta të krishtera (krh. *Rreg.* 14).
2. Në bazë të shpirtit të minoritetit, të zgjedhin një raport të preferuar ndaj të varfërve dhe të mënjanuarve, si të jenë ata një individ i vetëm ose një kategori personash ose një popull i tërë; të bashkëpunojnë në kapërcimin e çështjes së mënjanimit dhe ndaj atyre formave të varfërisë që janë fryt i paefektshmërisë dhe i padrejtësisë.

Neni 20

1. Të angazhuar për të ndërtuar Mbretërinë e Zotit në realitetet dhe veprimaritë e përkohshme, françeskanët shekullarë, nga thirrja e tyre përkatëse, jetojnë si realitet i pandashëm, me pjesëmarrjen e tyre në Kishë dhe në shoqëri. (krh. *Rreg.* 14).
2. Si ndihmë e parë dhe themelore në ndërtimin e një bote më të drejtë e vëllazërore, të angazhohen në plotësimin e detyrave përkatëse të aktivitetit të punës së tyre dhe në përgatitjen profesionale përkatëse. Me të njëjtin shpirt të shërbimit të marrin përgjegjësitë e tyre shoqërore e civile.

Neni 21

1. Për shën Françeskun puna është dhuratë dhe të punosh është dashamirësi. Puna e çdo dite është jo vetëm mjet ushqimi, por edhe rast i shërbimit ndaj Zotit e ndaj të afërmit dhe rrugë për të zhvilluar personalitetin përkatës. Në bindjen që puna është një e drejtë e një detyrë dhe që çdo formë e punësimit meriton respekt, vëllezërit të angazhohen për të bashkëpunuar me qëllim që të gjithë të kenë mundësinë për të punuar dhe proçeset e punës të jenë gjithmonë e më shumë njerëzore (krh. *Rreg.* 16).

2. Zbavitja dhe çlodhja kanë një vlerë përkatëse dhe janë të nevojshme në zhvillimin e personit. Françeskanët shekullarë të kujdesen për një raport të ekuilibruar ndërmjet punës e pushimit dhe t'i përdorin për të realizuar forma të kualifikuara të punësimit në kohën e lirë.

Neni 22

1. Françeskanët shekullarë "të jenë të pranishëm në fushën e jetës publike", të bashkëpunojnë, për sa të jetë e mundur për ata, për shpalljen e ligjeve dhe rregulloreve të drejta.
2. Në fushën e nxitjes njerëzore dhe të drejtësisë, Vëllazëritë duhet të angazhohen me nisma të guximshme, duke qenë në harmoni me thirrjen françeskane dhe me udhëzimet e Kishës. Të marrin qëndrime të drejta kur njeriu është i goditur në dinjitetin e tij për shkak të çfarëdolloj forme të shtypjes ose të indiferencës. Të ofrojnë shërbimin e tyre vëllazëror ndaj viktimave të padrejtësisë.
3. Heqja dorë nga përdorimi i dhunës, që është karakteristikë e nxënësve të Françeskut, nuk do të thotë heqje dorë nga veprimi; megjithatë, vëllezërit të kujdesen që ndërhyrjet e tyre të jenë gjithmonë të frymëzuara nga dashuria e krishterë.

Neni 23

1. Paqja është vepër e drejtësisë dhe fryt i pajtimit dhe i dashurisë vëllazërore. Françeskanët shekullarë janë të thirrur për të qenë prurësit e paqes në familjen e tyre dhe në shoqëri:

- të kujdesen për propozimin dhe përhapjen e ideve e të mënyrave të sjelljes paqësore;
- të zhvillojnë nisma vetjake dhe të bashkëpunojnë, në veçanti dhe si Vëllazëri, ndaj nismave të papës, të kishave të veçanta dhe të familjes françeskane;
- të bashkëpunojnë me lëvizjet dhe institucionet që nxisin paqen nën respektimin e themeleve të tij autentike.

2. Edhe pse duke njohur të drejtën si personale dhe kombëtare për t'u vetëmbrojtur, të vlerësojnë zgjedhjen e atyre që, me kundërshtim të ndergjegjshëm, nuk pranojnë të "mbajnë armë".
3. Për të mbrojtur paqen në familje, vëllezërit të bëjnë në kohën e duhur testamentin e të mirave të tyre.

Në familje

Neni 24

1. Françeskanët shekullarë të shikojnë familjen e tyre si mjedisin më të rëndësishëm në të cilin të jetojnë angazhimin e tyre të krishterë dhe thirrjen françeskane dhe në të, të hapin hapësirë për lutjen, për Fjalën e Zotit dhe për katekizmin e krishterë, duke e përdorur për respektimin e çdo jete nga fillimi i saj dhe në çdo rrethanë, deri në vdekje (krh. *Rreg. 17*).
Të martuarit të gjejnë në Rregullën e UFSH-së një ndihmë të vlefshme në udhëtimin e jetës së krishterë, të vetëdijshëm që, me sakramentin e Martesës, dashuria e tyre merr pjesë në dashurinë që Krishti ka për Kishën e tij. Dashuria e bashkëshortëve dhe deklarata e vlerës së besnikërisë janë një dëshmi e thellë për vetë familjen, për Kishën e për botën.
2. Në Vëllazëri:

- të jetë temë e dialogut dhe e transmetimit të përvojave, karakteri shpirtëror familjar e bashkëshortor dhe përcaktimi i krishterë i problemeve familjare;
- të ndahen çastet e rëndësishme të jetës familjare të bashkëvellëzërve dhe të kihet kujdes vëllazëror kundrejt -beqarëve o beqareve, të vejëve, prindërve të mbetur vetëm, të të ndarëve, të të shkurorëzuarve – që jetojnë në situata dhe kushte të vështira;
- Të krijohen kushte për dialogun ndërmjet brezave të ndryshme;
- të ndihmohet formimi i grupeve të të martuarve dhe i grupeve familjare (krh. *Rreg.* 19).

3. Vëllezërit të bashkëpunojnë ndaj përpjekjeve, që bëhen në Kishë e në shoqëri për të mbrojtur vlerën e besnikërisë dhe respektin ndaj jetës, dhe për të dhënë përgjigje ndaj çështjeve shoqërore të familjes.

Neni 25

Të bindur në domosdoshmërinë e edukimit "të fëmijëve në mënyrë që të hapin shpirtin e tyre ndaj bashkësisë dhe të fitojnë ndërgjegjen e të qenurit anëtarë të gjallë dhe aktiv të Popullit të Zotit" dhe nga hirësia që shën Françesku mund të ushtrojë mbi ata, të përkrahet formimi i grupeve të fëmijëve të cilët, me ndihmën e një pedagogjie dhe të një organizimi të përshtatur për moshën e tyre, të fillohen nga njohja dhe nga dashuria i jetës françeskane. Statutet kombëtare do të japin drejtimet e përshtatshme për organizimin e këtyre grupeve dhe për raportin e tyre me Vëllazërinë dhe me grupet e të rinjve françeskanë.

Lajmëtarët e gëzimit dhe të shpresës

Neni 26

1. Edhe me dhimbjen Françesku ka përjetuar besimin dhe gëzimin duke arritur:

- në eksperiencën e atësisë të Zotit;

- në besimin e patundur të ringjalljes me Krishtin në jetën e pavdekshme;
- në përvojën e mundësisë për të takuar e lavdëruar Krijuesin në vëllazërinë universale me të gjitha qeniet e krijuara.

Kështu që, në përputhje me Ungjillin, ata shprehin pohimin e tyre ndaj shpresës dhe ndaj gëzimit të jetës. Ofrojnë një ndihmë kundër anktheve të shumta të pesimizmit, duke përgatitur një të ardhme më të mirë (krh. *Rreg. 19*).

2. Në Vëllazëri, vëllezërit të nxisin marrëveshjen reciproke dhe të kujdesen që mjedisi i mbledhjeve të jetë mikpritës dhe të pasqyrojë gëzimin. Të inkurajohen ndërmjet tyre për të mirë.

Neni 27

1. Vëllezërit, duke iu shkuar mosha, të mësohen për të pranuar sëmundjen dhe rritjen e vështirësive edhe për t'i dhënë jetës së tyre një kuptim më të thellë, në shkëputjen progresive dhe drejtimin ndaj tokës së premtuar. Të jenë të bindur vendosmërisht që bashkësia e besimtarëve në Krishtin dhe të atyre që duhen tek Ai, do të vazhdojë në jetën e përjetshme si "bashkësi e shenjtërve" (krh. *Rreg. 19*).

2. Françeskanët shekullarë të angazhohen për të krijuar në mjedisin e tyre, e mbi të gjitha në Vëllazëritë, një frymë fetare dhe shpesë, më qëllim që "motra vdekje" të jetë e shikuar si kalim tek Ati dhe të gjithë mund të përgatiten me qetësi.

Kapitulli i tretë

JETESA NË VËLLAZËRI

Titulli I

ORIENTIMET E PËRGJITHSHME

Neni 28

1. Vëllazëria e UFSH-së gjen origjinën e saj në frymezimin e shën Françeskut të Asizit, të cilit Hyjnori i shfaqi thelbin ungjillor të jetës në bashkësi vëllazërore.

2. "UFSH-ja përbëhet nga vëllazëri në nivele të ndryshme", me qëllimin që të nxisin në formë të rregullt bashkimin dhe bashkëpunimin reciprok midis vëllezërve dhe praninë e tyre aktive dhe të përbashkët, si në Kishën lokale po ashtu dhe në Kishën universale. UFSH-ja do të ndihmojë, përveç në angazhimin e Vëllazërisë në shërbimin ndaj botës, veçanërisht edhe në jetën e shoqërisë (krh. *Rreg. 20*).
3. Vëllezërit bashkohen si në Vëllazëri lokale, të ngritura pranë një Kishe ose një shtëpie fetare, si në Vëllazëri personale, të krijuara për arsye të qarta, të vlefshme dhe të njohura me dekretin e ngritjes.

Neni 29

1. Vëllazëritë lokale të grumbullohen në Vëllazëri në nivele të ndryshme: krahinore, kombëtare, ndërkombëtare sipas kritereve kishtare, territoriale ose të një natyre tjetër. Ato janë të koordinuara e të lidhura në përputhje me normat e Rregullës e të Kushtetutave. Kjo është një nevojshmëri e bashkimit të Vëllazërive, e bashkëpunimit të rregullt ndërmjet tyre dhe të unitetit të UFSH-së.
2. Këto Vëllazëri, që secila prej tyre ka në veçanti një person juridik në Kishë, të fitojnë, nëse është e mundur, personalitetin juridik civil për të kryer sa më mirë misionin e tyre. I përket Këshillave kombëtare të japi orientime mbi shkaqet dhe mbi procedurat që duhen ndjekur (krh. *Rreg.* 20).
3. Statutet kombëtare duhet të tregojnë kriteret e organizimit të UFSH-së brenda shtetit. Zbatimi i këtyre kritereve i lihet gjykimit të vëmendshëm të Përgjegjësve të Vëllazërive të interesuara dhe të Këshillit Kombëtar.

Neni 30

1. Vëllezërit janë bashkëpërgjegjës të jetës së Vëllazërisë në të cilën bëjnë pjesë dhe anëtarët e UFSH-së si bashkim organik i të gjithë Vëllazërive të shpërndara nëpër botë.
2. Vetëdija e bashkëpërgjegjësisë të anëtarëve kërkon praninë personale, dëshminë, lutjen, bashkëpunimin aktiv sipas mundësive të secilit dhe të detyrave të mundshme në gjallërimin e Vëllazërisë.
3. Si në familje, secili nga vëllezërit të derdhë në arkën e Vëllazërise një kontribut sipas mundësive përkatëse me qëllim që të japë mjetet financiare që janë të nevojshme për jetën e Vëllazërisë dhe për veprat e saj të kultit, të apostullimit e të mirësisë. Vëllezërit të kujdesen gjithashtu për financimin dhe ndihma të tjera për të përballuar aktivitetet dhe veprat e Vëllazërisë të nivelit më të lartë (krh. *Rreg. 25*).

Neni 31

1. "Në nivele të ndryshme, çdo Vëllazëri është e gjallëruar dhe e drejtuar nga një Këshill dhe një Ministër (ose President)". Detyra të tilla dorëzohen gjatë zgjedhjeve në

përputhje me Rregullën, Kushtetutat dhe Statutet përkatëse. Vetem në raste të jashtëzakonshme ose në fazën e parë të krijimit të tyre, mund të ekzistojnë Vëllazëri pa një Këshill të rregullt. Këtë mangësi e përballon Këshilli i nivelit më të lartë per një periudhë sa më të shkurtër të nevojshme për të siguruar rifillimin ose nisjen e Vëllazërisë, formimin e gjallëruesve të saj dhe shpalljen e zgjedhjeve (krh. *Rreg. 21*).
2. Detyra e Ministrit ose e Këshilltarit është një shërbim vëllazëror, një përgjegjësi për t'u ndjerë i gatshëm e i përgjegjshëm kundrejt çdo vëllai dhe ndaj Vëllazërisë, derisa çdonjëri të realizohet në thirrjen përkatëse dhe çdo Vëllazëri të jetë një bashkësi e vërtet kishtare françeskane, aktivisht e pranishme në Kishë dhe në shoqëri.
3. Përgjegjësat e UFSH-së të çdo niveli të jenë vëllezër të kushteve të përjetshme, të bindur në vlerën e jetës ungjillore françeskane, të kujdesshëm me shikim largpamës e bujar ndaj jetës së Kishës dhe të shoqërisë, të disponueshëm ndaj dialogut, të gatshëm për të dhënë e për të marrë ndihmë dhe bashkëpunim.
4. Përgjegjësat të kurojnë përgatitjen dhe gjallërimin shpirtëror dhe teknik të mbledhjeve, si të Vëllazërive dhe të Këshillave. Të kërkojnë të japin zemër dhe jetë Vëllazërisë me anën e dëshmisë përsonale, duke këshilluar mjetet e përshtatshme për zhvillimin e jetës së Vëllazërisë dhe të aktiviteteve apostullare, nën dritën e preferencave themelore françeskane. Të kujdesen që vendimet e marra të jenë të zbatuara dhe të nxisin bashkëpunimin e vëllezërve.

Neni 32

1. Ministrat dhe Këshilltarët të jetojnë e të nxisin shpirtin dhe realitetin e bashkësisë midis vëllezërve, ndërmjet Vëllazërive të ndryshme e midis tyre dhe Familjes Françeskane. Të kenë në zemër, mbi çdo gjë tjetër, paqen dhe pajtimin në ambientin e Vëllazërisë.
2. Detyra e udhëheqjes nga Ministrat dhe nga Këshilltarët është e përkohshme. Vëllezërit, duke shmangur çfarëdo ambicioni, duhet të tregojnë dashurinë ndaj Vëllazërisë me shpirtin e shërbimit dhe me gadishmërinë si për të pranuar po ashtu dhe për të lënë detyrën (krh. *Rreg.* 21).

Neni 33

1. Në drejtimin dhe koordinimin e Vëllazërive dhe të Urdhrit, duhet të nxitet përsonaliteti dhe aftësia e secilit prej vëllezërve edhe nga Vëllazëritë e veçanta, dhe të respektohen format e shumëllojshme të shprehjeve të idealit françeskan, dhe larmia kulturore.
2. Këshillat e nivelit më të lartë të mos bëjnë atë që mund të kryhet në mënyrë të përshtatshme si nga Vëllazëritë lokale, si dhe nga një Këshill i nivelit me poshtë; të respektojnë dhe të nxisin gjallërinë e tyre derisa ata të zbatojnë në mënyrë të përshtatshme detyrat përkatëse. Vëllazëritë lokale dhe Këshillat e interesuar të

angazhohen për të vënë në zbatim vendimet e Këshillit ndërkombëtar dhe të Këshillave të tjerë të nivelit më lartë edhe për të vënë në zbatim programet duke i përshtatur, në rastin kur do të duhen, në realitetin përkatës.

Neni 34

Në ambientin e Vëllazërisë, atje ku kushtet e mjedisit dhe nevojat e anëtarëve të saj e kërkojnë, mund të krijohen, nën drejtimin e një Këshilli të vetëm, seksione ose grupe që të mbledhin anëtarët të bashkuar nga nevoja të veçanta, nga ngjashmëritë e interesave ose nga të njëjtat përzgjedhje vepruese.
Të tilla grupe do të mundohen të japin norma të posaçme në lidhje me takimet dhe aktivitetet, duke mbetur e pandryshuar besnikëria ndaj kërkesave që lindin nga pjesëmarrja në një Vëllazëri. Statutet kombëtare vendosin kriteret e përshtatshme për formimin dhe funksionimin e seksioneve ose të grupeve.

Neni 35

1. Meshtarët shekullarë, që njihen të thirrur nga Shpirti për të marrë pjesë në hirësinë e shën Françeskut të Asizit në Vëllazërinë shekullare, të gjejnë në të një vëmendje të veçantë, në përputhje me misionin e tyre ndaj Popullit të Zotit.
2. Meshtarët shekullarë françeskanë mund të mblidhen edhe në Vëllazëri personale, me qëllim që të thellojnë nxitjet asketike e baritore që jeta dhe doktrina e Françeskut dhe Rregulla e UFSH-së iu ofron atyre për të jetuar më mirë thirrjen e tyre brenda Kishës. Është e arsyeshme që këto Vëllazëri të kenë Statutet e veta që të parashikojnë mënyrat konkrete në lidhje me përbërjen, me takimet vëllazërore e me formimin shpirtëror, dhe për të bërë të gjallërueshëm e veprues bashkësinë me të gjithë Urdhrin.

Neni 36

1. Mund të jenë një ndihmë e madhe në zhvillimin shpirtëror dhe apostullor të UFSH-së vëllezërit që, me votat personale, zotohen për të jetuar shpirtin e Lumturive Ungjillore dhe të bëhen më të gatshëm ndaj soditjes dhe ndaj shërbimit në Vëllazëri.
2. Këta vëllezër e motra mund të mblidhen në grupe, sipas Statuteve të miratuara nga Këshilli kombëtar, ose, kur përhapja e këtyre grupeve kalon kufijtë e një shteti, nga Presidenca e CIOFS-së.
3. Këto Statute duhet të jenë në harmonizim me Kushtetutat e tanishme.

Titulli II

HYRJA NË URDHËR DHE FORMIMI

Neni 37

1. Përfshirja në Urdhër realizohet nëpërmjet një periudhe të fillimit, një periudhe të formimit dhe Kushtet e Rregullës (krh. *Rreg. 23*).
2. Që me hyrjen në Vëllazëri fillohet udha e formimit, që duhet të zhvillohet për gjithë jetën. Të vetëdijshëm që Shpirti Shenjt është vepruesi kryesor i formimit dhe gjithnjë të kujdesshëm për të bashkëpunuar me Të, përgjegjës të formimit janë: kandidati vetë, tërë Vëllazëria, Këshilli me Ministrin, Mësuesi i formimit dhe Asistenti.
3. Vëllezërit janë përgjegjës të formimit përkatës për të zhvilluar thirrjen që kanë marrë nga Zoti në mënyrë gjithnjë e më të përsosur. Vëllazëria është e thirrur për të ndihmuar vëllezërit në këtë udhëtim me anë të mikpritjes, me lutje dhe me shembull.
4. U përket Këshillave kombëtare dhe krahinore, në marrëveshje të përbashkët, përpunimi dhe adoptimi i mjeteve të formimit të përshtatshme me situatat lokale, në ndihmë ndaj përgjegjësve të formimit të secilës Vëllazëri.

Periudha e fillimit

Neni 38

1. Periudha e fillimit, është një fazë përgatitjeje për kohën e formimit të vërtetë dhe përkatës dhe është e përcaktuar për gjykimin e thirrjes së aspirantit dhe për njohjen e ndërsjellë midis Vëllazërisë e aspirantit. Duhet të garantojë lirinë dhe seriozitetin e hyrjes në UFSH (krh. *Rreg. 23*).
2. Jetëgjatësia dhe mënyrat e zhvillimit të periudhës së fillimit janë të përcaktuara nga Statutet kombëtare.
3. I përket Këshillit të Vëllazërisë detyra e vendosjes së përjashtimeve të mundshme nga periudha e fillimit, duke mbajtur parasysh orientimet e Këshillit kombëtar.

Pranimi në Urdhër

Neni 39

1. Kërkesa e pranimit në Urdhër i paraqitet nga aspiranti Ministrit të një Vëllazërie lokale o personale në mënyrë zyrtare, mundësisht me shkrim (krh. *Rreg. 23*).
2. Kushtet për pranimin janë: premtimi i fesë katolike, jetesa në bashkësi me Kishën, të kihet një sjellje morale e mirë, demonstrimi me shenja të qarta të thirrjes.
3. Këshilli i Vëllazërisë vendos njëzëri mbi kërkesën dhe i jep përgjigje zyrtare aspirantit dhe jep njoftimin në Vëllazëri.

4. Akti i pranimit të zhvillohet sipas Ritualit. Akti vjen i regjistruar dhe i ruajtur në arkivin e Vëllazërisë.

Periudha e formimit

Neni 40

1. Periudha e Formimit fillestar ka kohëzgjatje të paktën një vit. Statutet kombëtare mund të fiksojnë një kohëzgjatje më të madhe. Qëllimi i kësaj periudhe është pjekja e thirrjes, përvoja e jetës ungjillore në Vëllazëri, njohja më e mirë e Urdhrit. Ky formim të jetë i jetuar me mbledhje të shpeshta studimi e lutjesh dhe me përvoja konkrete të shërbimit e të apostullimit. Të tilla mbledhje, për sa është e mundur dhe e duhur, të mbahen së bashku me kandidatët e Vëllazërive të tjera (krh. *Rreg. 23*).
2. Kandidatët udhëhiqen në leximin dhe meditimin e Shkrimeve të Shenjta, në njohjen e personit dhe të shkrimeve të Françeskut e të karakterit shpirtëror françeskan, në studimin e Rregullës dhe të Kushtetutave. Edukohen për të dashur Kishën e për të mirëpritur Magjisterin e saj. Laikët të ushtrohen për të jetuar në mënyrë ungjillore detyrën e përkohshme në botë.
3. Pjesëmarrja në mbledhjet e Vëllazërisë lokale është një kusht paraprak nga i cili nuk hiqet dorë për të qenë të filluar me lutjen e përbashkët dhe me jetesën në vëllazëri.
4. Të adoptohet një pedagogji e mënyrës françeskane dhe e përputhshme me mentalitetin e ambientit.

Kushtet ose Premtimi i jetës ungjillore

Neni 41

1. Kandidati, pasi ka përfunduar periudhën e formimit fillestar, i bën kërkesë Ministrit të Vëllazërisë lokale për të dhënë Kushtet. Këshilli i Vëllazërisë, pasi ka dëgjuar Mësuesin e formimit dhe Asistentin, vendos nëpërmjet votimit sekret për pranimin në Premtim dhe i jep përgjigjen kandidatit dhe e shpall në Vëllazëri (krh. *Rreg. 23*).
2. Kushtet për Premtimin ose Kushtet e jetës ungjillore janë:
- mbushja e moshës e vendosur nga Statutet Kombëtare;
- pjesëmarrja aktive në formimin fillestar të paktën për një vit;
- dhënia e pëlqimit nga Këshilli i Vëllazërisë lokale.

3. Në rastet kur mendohet se është e duhur që të zgjatet periudha e formimit fillestar, ajo s'mund të shtyhet për më shumë se një vit nga periudha e përcaktuar nga Statutet kombëtare.

Neni 42

1. Kushtet jane akti kishtar solemn, me të cilin kanditati, i vetëdijshëm në thirrjen e marrë nga Krishti, ripërtërin premtimet e pagëzimit dhe bën të ditur publikisht angazhimin e tij për të jetuar Ungjillin në botë sipas shembullit të Françeskut e duke ndjekur Rregullën e UFSH-së.
2. Kushtet përfshijnë kandidatin në Urdhër dhe është në vetvete një detyrim i përjetshëm. Kushtet e përjetshme, për arsye pedagogjike objektive dhe reale, mund të jenë të paraprira nga Kushtet e përkohshme të ripërtërira çdo vit. Periudha e plotë e Kushteve të përkohshme nuk mund të zgjasë më shumë se tre vjet (krh. *Rreg.* 23).
3. Kushtet merren nga Ministri i Vëllazërisë lokale, ose nga një i deleguar i tij, në emër të Kishës e të UFSH-së. Kremtimi të zhvillohet sipas udhëzimeve të Ritualit.
4. Kushtet nuk angazhojnë vetëm të përkushtuarit[3] kundrejt Vëllazërisë, përkundrazi në të njëjtën mënyre angazhon Vëllazërinë për t'u përkujdesur për mirëqenien e tyre njerëzore e fetare.
5. Akti i Kushteve regjistrohet dhe ruhet në arkivin e Vëllazërisë.

Neni 43

Statutet kombëtare vendosin:

- moshën minimale për Kushtet, që megjithatë nuk mund të jetë më pak se 18 vjeç të mbushura (krh. *Rreg. 23*);
- shenja dalluese e anëtarësisë në Urdhër ("TAU" ose ndonjë simbol tjetër françeskan).

Formimi i përhershëm

Neni 44

1. E filluar në etapat e mëparshme, formimi i vëllezërve zbatohet në mënyrë të përhershme dhe të vazhdueshme. Ajo duhet kuptuar si ndihmë në shndërrimin[14] e çdonjërit dhe të të gjithëve, dhe në përmbushjen e misionit përkatës në Kishë dhe në shoqëri.
2. Vëllazëria ka për detyrë t'i kushtojë një vëmendje të posaçme ndaj formimit të të përkushtuarve të rinj dhe të përkushtuarve të përkohshëm, për të ndihmuar pjekjen e thirrjes së tyre dhe për të ngulitur ndjenjën e anëtarësisë.
3. Formimi i përhershëm, edhe nëpërmjet kurseve, takimeve, shkëmbimit të përvojave, ka për detyrë të ndihmojë të gjithë vëllezërit:

- për të dëgjuar e medituar Fjalën e Zotit, "duke kaluar nga Ungjilli në jetë dhe nga jeta në Ungjill" (krh. *Rreg. 4*);
- për të reflektuar, të ndriçuar nga feja e të ndihmuar nga dokumentat e Magjisterit, mbi ndodhitë e Kishës e të shoqërisë duke marrë, si rrjedhim, qëndrimet koherente;

- për të zbatuar e thelluar thirrjen françeskane duke studiuar shkrimet e Shën Françeskut, të Shenjtes Kjarë dhe të autorëve françeskanë.

Kujdesi për thirrjen[15]

Neni 45

1. Kujdesi për thirrjen në Urdhër është një detyrë e të gjithë vëllezërve dhe është shenjë e gjallërisë të Vëllazërive përkatëse.
Vëllezërit, të bindur në vlerën e formës françeskane të jetës, lusin Zotin që të japë hirin e thirrjes françeskane për anëtarë të rinj.
2. Edhe pse asgjë nuk mund të zëvendësojë dëshminë e çdonjërit e të Vëllazërive, Këshillat duhet të adoptojnë mjete të përshtatshme për të nxitur thirrjen shekullare françeskane.

Titulli III

VËLLAZËRIA NË NIVELE TË NDRYSHME

Vëllazëria lokale

Neni 46

1. Ngritja e ndërtesës së Vëllazërisë lokale i përket komponentit Epror (shërbyesi kishtar më i lartë) me kërkesën e vëllezërve të interesuar, pas një konsultimi paraprak dhe me bashkëpunimin e Këshillit të nivelit më të lartë, me të cilin Vëllazëria e re do të jetë në marrëdhënie sipas Statutit kombëtar (*Rreg. 22*).
Është i nevojshëm miratimi me shkrim i ipeshkvit të vendit për ngritjen e kanonikës së një Vëllazërie, jashtë nga shtëpitë ose kishat e shërbyesve kishtarë françeskanë të Urdhrit të Parë ose të TOR-së.
2. Për ngritjen e vlefshme të një Vëllazërie lokale kërkohen të paktën pesë anëtarë të përkushtuar me kushtet e përjetshme. Pranimi dhe Kushtet e këtyre vëllezërve të parë do të jenë të dhëna nga Këshilli i një Vëllazërie tjetër lokale ose nga Këshilli i nivelit më të lartë, që në mënyrat e duhura do të ketë patur kujdes formimin. Dokumentacionet e akteve të pranimit e të Kushteve dhe dekreti i ngritjes ruhen në arkivin e Vëllazërisë, duke dërguar kopjen në Këshillin e nivelit më të lartë.

3. Në qoftë se në një shtet nuk ekzistojnë akoma Vëllazëri të UFSH-së, sipas meritës i përket Kryesisë së CIOFS-së të përkujdeset.

Neni 47

1. Çdo Vëllazëri lokale, qeli bazë e një UFSH-je të vetëm, mirëbesohet nën kujdesin baritor të Urdhrit të shërbimit fetar françeskan që e ka ngritur sipas normativave të KDK-së (krh. *Rreg. 22*).
2. Vëllazëria lokale mund të kalojë nën kujdesin baritor të një tjetri Urdhri shërbyes fetar françeskan me mënyrat e parashikuara nga Statutet kombëtare.

Neni 48

1. Në rastin e mbylljes të një Vëllazërie, të mirat e pronësisë së saj, biblioteka dhe arkivi merren nga Vëllazëria e nivelit drejtpërdrejt më të lartë.
2. Në rastin e ringjallërimit sipas ligjeve kanonike, Vëllazëria do të rimarrë mundësisht pronat e mbetura, bibliotekën që i përket dhe arkivin.

Këshilli i Vëllazërisë

Neni 49

1. Këshilli i Vëllazërisë lokale është i formuar nga detyrat që vijojnë: Ministri, Zëvendës Ministri, Sekretari, Përgjegjësi i Thesarit dhe Mësuesi i formimit. Sipas nevojave të secilës Vëllazëri, mund t'u shtohen detyra të tjera. Ka të drejtën të bëjnë pjesë në Këshill, Assistenti shpirtëror i Vëllazërisë .
2. Vëllazëria, e bashkuar në Asamble ose Kapitull, trajton argumentet që interesojnë jetën e saj dhe organizimin. Çdo tre vjet, në Asemble ose në Kapitull të zgjedhur, zgjidhet Ministri dhe Këshilli sipas normave të parashikuara nga Kushtetutat dhe nga Statutet.

Neni 50

1. I përket Këshillit të Vëllazërisë lokale:

- të nxisë nismat e nevojshme për të ndihmuar jetën vëllazërore, për të zhvilluar formimin njerëzor, të krishterë dhe françeskan të anëtarëve të saj, për t'i mbështetur në dëshminë e tyre dhe në angazhimin në botë;
- të bëjë zgjedhje konkrete dhe të guximshme, të përshtatshme me gjendjen e Vëllazërisë, midis shumëllojshmërisë së aktiviteteve të mundshme në fushën e apostullimit.

2. Janë, gjithashtu, detyra të Këshillit:

a. të caktojë hyrjen dhe pranimin në Kushte të vëllezërve të rinj;

b. të vendosë një dialog vëllazëror me anëtarët që gjenden në vështirësi të veçanta dhe të adoptojë si rrjedhim masat;
c. të pranojë kërkesën e tërheqjes dhe të vendosë pezullimin e një anëtari të Vëllazërisë;
d. të përcaktojë kushtetutën e seksioneve ose të grupeve, në përputhje me Kushtetutat e me Statutet;
e. të përcaktojë në bazë të vendit ku do shkojnë fondet e disponueshme dhe, në përgjithësi, të vendosë në çështjet që rishikojnë administrimin financiar dhe marrëveshjet ekonomike të Vëllazërisë;
f. të japë detyrat Këshilltarëve dhe rregulltarëve të tjerë;
g. të kërkojë rregulltarë të aftë e të përgatitur si Asistentë të kompetentëve Eprorë të Urdhrit të Parë e të TOR-së;
h. të kryejë së bashku me detyrat e tjera të shprehura nga Kushtetutat ose të nevojshme për të arritur qëllimet e veta.

Detyrat në Vëllazëri

Neni 51

1. Duke mbetur e pandryshuar bashkëpërgjegjësia e Këshillit në gjallërimin dhe drejtimin e Vëllazërisë, i përket Ministrit, që është përgjegjësi i parë i Vëllazerisë, të kujdeset që të vihen në zbatim orientimet e vendimet e Vëllazërisë dhe të Këshillit, të cilin do ta informojë për veprën e tij.
2. Ministri, gjithashtu, ka për detyrë:
a. të thërrasë, kryesojë dhe drejtojë mbledhjet e Vëllazërisë dhe të Këshillit; të thërrasë çdo tre vjet Kapitullin e zgjedhur të Vëllazërisë, pas dëgjimit të Këshillit mbi formalitetin e thirrjes;
b. të përgatisë relacionin vjetor për t'ia dërguar Këshillit të nivelit me lartë, pasi t'i nënshtrohet aprovimit prej Këshillit të Vëllazërisë;
c. të përfaqësojë Vëllazërinë në të gjitha marrëdhëniet me autoritetet kishtare e civile. Kur Vëllazëria të marrë përsonalitet juridik në sistemin civil, Ministri merr përsipër, nëse është i mundshëm, përfaqësimin e ligjshëm;
d. të kërkojë me pëlqimin e Këshillit, vizitën baritore dhe vizitën vëllazërore të paktën një herë në çdo tre vjet;
e. të vëjë në zbatim aktet që Kushtetutat vendosin nën kompetencat e tij.

Neni 52

1. Zëvendës Ministri ka për detyrë:
a. të bashkëpunojë me Ministrin me frymë vëllazërore dhe ta ndihmojë në zhvillimin e detyrave që i përkasin;

b. të ushtrojë funksionet që i janë besuar nga Këshilli *dhe* ose *nga* Asamblea ose Kapitulli;

c. të zëvendësojë Ministrin në kompetencat e tij dhe në përgjegjësi, në rastin kur mungon ose të pamundësisë së përkohshme;

d. të marrë përsipër funksionet e Ministrit kur detyra mbetet vakante.

2. Sekretari ka për detyrë:

a. të shkruajë aktet zyrtare të Vëllazërisë e të Këshillit dhe të kujdeset në dërgimin te personat përkatës;

b. të kujdeset për ripërtëritjen dhe mbajtjen e arkivit e të regjistrave duke marrë shënim pranimet, Kushtet, vdekjet, tërheqjet dhe transferimet e Vëllazërisë;

c. të përkujdeset në komunikimin e fakteve më të rëndësishme në nivele të ndryshme dhe, nëse është e duhur, në përhapjen e tyre nëpërmjet medias[16].

3. Mësuesi i formimit, ka për detyrë:

a. të koordinojë, me ndihmën e anëtarëve të tjerë të Këshillit, aktivitetet formuese të Vëllazërisë;

b. të mësojë e të frymëzojë kandidatët gjatë periudhës së pjesëmarrjes, kandidatët në kohën e formimit fillestar dhe rregulltarët e rinj;

c. të informojë Këshillin e Vëllazërisë, para pranimit në Kushtet, mbi aftësinë e kandidatit për t'u angazhuar në jetën sipas Rregullës.

4. Përgjegjësi i Thesarit ose ekonomisti ka për detyrë:

a. të ruajë me kujdes ndihmat e marra, duke shënuar në regjistrin përkatës të ardhurat një nga një, datën në të cilën i janë dorëzuar dhe emrin e dhuruesit, ose të atij që i ka mbledhur;

b. të shënojë në të njëjtin regjistër zërat përkatës me shpenzimet, duke përcaktuar datën dhe vendarritjen, në përputhje me udhëzimet e Këshillit të Vëllazërisë;

c. të japë llogari për administrimin e tij në Asamblenë dhe në Këshillin e Vëllazerisë në përputhje me normat e Statutit kombëtar.

5. Udhëzimet që shikojnë kompetencat e Zëvendës Ministrit, Sekretarit dhe Përgjegjësit të Thesarit vlejnë, me përshtatjet e volitshme, në të gjitha nivelet.

Pjesëmarrje në jetën e Vëllazërisë

Neni 53

1. Vëllazëria duhet t'u ofrojë anëtarëve të saj mundësi të takimit dhe të bashkëpunimit nëpërmjet mbledhjeve, për t'i kryer sa më shpesh që jepet mundësia nga situatat e mjedisit dhe me përfshirjen e të gjithëve (krh. *Rreg.* 24).

2. Vëllazëria të mblidhet në mënyrë periodike si komunitet kishtar për të kremtuar Eukaristinë në një atmosferë që të përforcojë lidhjen vëllazërore dhe të karakterizojë

identitetin e Familjes Françeskane. Atje ku nuk është e mundur kremtimi i veçantë, të merret pjesë në kremtimin e një bashkësie kishtare (krh. *Rreg.* 6; 8).
3. Përfshirja në një Vëllazëri lokale dhe marrja pjesë në jetën e vëllazërisë është thelbësore për pjesëmarrjen në UFSH. Nismat e nevojshme duhet të jenë të adoptuara, sipas orientimeve të Statuteve kombëtare, për të mbajtur të bashkuar ndaj Vëllazërisë, vëllezërit që - për arsye reale të shëndetit, të familjes, të punës ose të distancës - janë të penguar për të marrë pjesë në mënyrë aktive në jetën e bashkësisë.
4. Vëllazëria kujton me mirënjohje vëllezërit e vdekur dhe vazhdon bashkimin me ta në lutje e në Sakramentin e Eukaristisë.
5. Statutet kombëtare mund të parashikojnë forma të veçanta të pranimit në Vëllazëri për ata që, pa pjesëmarrje në UFSH, duan të ndajnë jetën dhe aktivitetet.

Neni 54

1. Në rastin kur Vëllazëria e çfarëdo niveli zotëron një pasuri të luajtshme ose të paluajtshme, do të duhen të nxiten, në përputhje me Statutet kombëtare, nismat e nevojshme derisa Vëllazëria vetë të fitojë personalitetin juridik civil.
2. Statutet kombëtare, në bazë të legjislacionit civil përkatës, duhet të vendosin kritere të sakta për finalitetet e personit juridik, për administrimin e pasurive dhe kontrollet e brendshme përkatëse; duhet të përmbajnë edhe udhëzime me qëllim që akti kushtetues t'i ketë në dispozicion përsa i përket kalimit të pronësisë së tij në rastin e zhdukjes së personit juridik.
3. Statutet kombëtare duhet të vendosin, gjithashtu, kritere të sakta derisa, në Vëllazëritë lokale që kanë pronësi ose që i administrojnë, Këshilli përkatës, më parë se të mbarojë mandatin, të bëjë verifikimin nga një ekspert, që nuk është anëtar i Këshillit, ose nga kolegji i revizorëve të llogarive të Vëllazërisë, gjendjen financiare dhe pronësore të Vëllazërisë.

Transferimi

Neni 55

Nëse një vëlla, për çfarëdo shkaku të arsyeshëm, dëshiron të kalojë në një Vëllazëri tjetër, informon paraprakisht Këshillin e Vëllazërisë në të cilën është pjesë, i bën kërkesën e arsyetuar Ministrit të Vëllazërisë në të cilën dëshiron të jetë i pranuar. Këshilli i kësaj të fundit vendos pasi ka marrë me shkrim informacionet e duhura nga Vëllazëria nga e cila vjen.

Masat e përkohshme

Neni 56

1. Vëllezërit që gjenden në vështirësi mund të kërkojnë, me akt formal, tërheqjen e përkohshme nga Vëllazëria. Këshilli do të vlerësojë kërkesën, me mirësi dhe urtësi, pas një dialogu vëllazëror të Ministrit e të Asistentit me të interesuarin. Nëse arsyet duken të vërteta, pas një periudhe për të lejuar vëllain në vështirësi që të mendojë përsëri, Këshilli pranon kërkesën e tij (krh. *Rreg. 2.*3).

2. Shkeljet e përsëritura e të zgjatura ndaj detyrimeve që rrjedhin nga jetesa në Vëllazëri dhe nga sjelljet e tjera në kundërshtim të rëndë me Rregullin duhen të trajtohen nga Këshilli në dialog me vëllain shkelës. Vetëm në rastin e këmbënguljes ose të përsëritjes, Këshilli mund të vendosë, me votim të fshehtë, pezullimin, duke ia komunikuar me shkrim të interesuarit.

3. Tërheqja me dashje o masa e pezullimit duhet të jetë e shënuar në regjistrat e Vëllazërisë. Sjell përjashtimin nga mbledhjet dhe nga aktivitetet e Vëllazërisë, duke përfshirë edhe të drejtën e zërit aktiv e pasiv, por mbetet e pandryshuar anëtarësia në Urdhër.

Neni 57

1. Françeskani shekullar, në rastin e tërheqjes me dashje o të pezullimit nga Vëllazëria, mund të kërkojë që të jetë i ripranuar duke i drejtuar kërkesën përkatëse me shkrim Ministrit.

2. Këshilli, pasi ka shqyrtuar arsyet e paraqitura nga i interesuari, vlerëson nëse mund të quhen të kapërcyera shkaqet që kishin përcaktuar tërheqjen ose pezullimin dhe, në rast pohues, e pranon përsëri, duke shënuar vendimin në aktet e Vëllazërisë.

Masat përfundimtare

Neni 58

1. Vëllai që ka ndërmend të tërhiqet përfundimisht nga Urdhri, ia komunikon me shkrim qëllimin e tij Ministrit të Vëllazërisë. Ministri dhe Asistenti i Vëllazërisë lokale, me mirësi e kujdes, hapin një dialog me vëllain e interesuar, duke mbajtur të informuar Këshillin. Nëse vëllai përforcon me shkrim vendimin e tij, Këshilli merr shënim, dhe i jep komunikimin me shkrim të interesuarit. Tërheqja përfundimtare është e shënuar në regjistrat e Vëllazërisë dhe e komunikuar në Këshillin e nivelit më të lartë.

2. Në praninë e shkaqeve të rënda, të jashtme, të përgjegjshme dhe ligjërisht të provuara, Ministri ose Asistenti i Vëllazërisë lokale, me mirësi dhe kujdes, hapin një dialog me vëllain e interesuar, duke mbajtur të informuar Këshillin. Vëllait i jepet një periudhë për të reflektuar dhe arsyetuar, dhe i ofrohet, në qoftë e nevojshme, një ndihmë nga jashtë dhe kompetente. Nëse koha e reflektimit kalon pa rezultat, Këshilli i

Vëllazërisë kërkon nga Këshilli i nivelit më të lartë të nxjerrë vëllain nga Urdhri. Kjo kërkesë duhet të jetë e shoqëruar nga i gjithë dokumentacioni ndaj çështjes përkatëse.
Këshilli i nivelit më të lartë do të lëshojë dekretin e dorëheqjes, pasi të ketë shqyrtuar në mënyrë kolegjiale kërkesën me dokumentacionin përkatës dhe kontrolluar respektimin e normave të së Drejtës Kanonike dhe të Kushtetutave.
3. Vëllai, që publikisht braktis fenë, nuk është më në bashkësinë kishtare o në të cilën jepet ose deklarohet masa ndëshkimore e shkishërimit, për të njëjtin fakt nuk bën pjesë në Urdhër. Kjo nuk pengon Këshillin e Vëllazërisë lokale të hapë një dialog me të interesuarin dhe t'i ofrojë një ndihmë vëllazërore. Këshilli i nivelit më të lartë, me kërkesën e Këshillit të Vëllazërisë lokale, mbledh provat dhe vërteton zyrtarisht nëse ka ndodhur humbja e të drejtës nga Urdhri.
4. Dekreti i dorëheqjes ose i humbjes të së drejtës nga Urdhri, që të bëhet ekzekutiv, duhet të jetë i ripohuar nga Këshilli kombëtar, të cilit do ti dërgohet gjithë dokumentacioni.

Neni 59

Kushdo që ndihet i dëmtuar nga një masë e marrë në drejtim të tij mund të kërkojë brenda tre muajsh nga Këshilli i nivelit më lartë nga ai që ka marrë vendimin dhe, në instancat e mëtejshme, në nivelet e mëtejshme deri te Presidenca e CIOFS-së dhe, në instancën e fundit, nga Selia e Shenjtë.

Neni 60

Aq sa thuhet në këto Kushtetuta në lidhje me Vëllazërinë lokale vlen, për sa është e zbatueshme, edhe për Vëllazeritë personale.

Vëllazëria krahinore

Neni 61

1. Vëllazëria krahinore është bashkimi organik i të gjitha Vëllazërive lokale që gjenden në një hapësirë territoriale ose që munden të integrohen në një njësim të natyrshëm si për afërsinë gjeografike dhe për problemet e përbashkëta e realitetet baritore. Siguron lidhjen midis Vëllazërive lokale dhe asaj Kombëtare, nëpërmjet respektimit të njësimit të UFSH-së dhe me integrimin kolegjial të Urdhrave rregulltarë françeskanë, që në mënyrë përkatëse kujdesen për ndihmesën shpirtërore në atë rajon.
2. Kushtetuta e Vëllazërisë krahinore i përket Këshillit Kombëtar sipas Kushtetutave dhe Statuteve kombëtare; të jenë të informuar komponentët Eprorr-rregulltar të cilëve do të duhet t'iu kërkohet ndihmesa shpirtërore.
3. Vëllazëria krahinore:

- është e gjallëruar dhe e drejtuar nga një Këshill dhe një Ministër;
- është e rregulluar nga Statuti kombëtar dhe nga Statuti përkatës;
- ka një seli përkatëse.

Neni 62

1. Këshilli krahinor përbëhet sipas normave të Statutit kombëtar dhe të Statutit përkatës. Në gjirin e Këshillit krahinor mund të ndërtohet një këshill ekzekutiv, me detyra të dhëna nga Statutet.

2. Këshilli i rrethit ka për detyrë:

a. të përgatisë kremtimin e Kapitullit të zgjedhur;

b. të nxisë, të gjallërojë e koordinojë, në mjedisin krahinor, jetën dhe aktivitetet e UFSH-së dhe përfshirjen e tij në Kishën lokale;

c. të hartojë, sipas udhëzimeve të Këshillit kombëtar dhe në bashkëpunim me të, programin e punës së UFSH-së në krahinë dhe të kujdeset për shpërndarjen e tij në Vëllazëritë lokale;

d. të transmetojë në Vëllazëritë lokale direktivat e Këshillit kombëtar dhe të Kishës së veçantë;

e. të kujdeset për formimin e gjallëruesve;

f. të ofrojë në Vëllazëritë lokale aktivitete ndihmëse për kërkesat e tyre formuese dhe vepruese;

g. të diskutojë dhe miratojë raportin vjetor për Këshillin kombëtar;

h. të vendosë vizitën vëllazërore në Vëllazeritë lokale, edhe pse nuk është e kërkuar, por kur rrethanat e këshillojnë;

i. të vendosë në saje të qëllimit të caktuar të fondeve të disponueshme dhe, në përgjithësi, merr vendime për sa i përket çështjeve që përfshijnë administrimin financiar dhe marrëdhëniet ekonomike të Vëllazërisë së rrethit;

l. para mbarimit të mandatit të tij, të bëjë verifikimin nga një person ekspert, që të mos jetë anëtar i Këshillit, ose nga kolegji i revizorëve të llogarive të Vëllazërisë, të gjendjes financiare dhe pronat e Vëllazërise krahinore;

m. të përmbushë detyrat e tjera të përcaktuara nga Kushtetutat ose që janë të nevojshme për të arritur qëllimet e veta.

Neni 63

1. Duke theksuar bashkëpërgjegjësinë e Këshillit në inkurajimin dhe drejtimin e Vëllazërisë krahinore, i takon Ministrit, që është përgjegjësi i parë, të kujdeset që të vihen në zbatim orientimet dhe vendimet e Këshillit, që do ta informojë për veprimtarinë e tij.

2. Ministri i krahinës, gjithashtu, ka për detyrë:

a. të thërrasë dhe të kryesojë mbledhjet e Këshillit krahinor; të thërrasë çdo tre vjet Kapitullin e zgjedhur krahinor, pasi të ketë dëgjuar Këshillin mbi formalitetet e mbledhjes;
b. të kryesojë dhe të garantojë zgjedhjet e Vëllazërive lokale, personalisht ose nëpërmjet një delegati anëtar i Këshillit e krahinor por mos të jetë Asistenti shpirtëror;
c. të kryejë vizitën vëllazërore në Vëllazëritë lokale, personalisht ose nëpërmjet një delegati, anëtar i Këshillit;
d. të marrë pjesë në takimet e vendosura nga Këshilli kombëtar;
e. të përfaqësojë Vëllazërinë në rast se ajo fiton personalitetin juridik në sistemin civil;
f. të përgatisë raportin vjetor për Këshillin kombëtar;
g. të kërkojë, të paktën një herë në tre vjet, me lejen e Këshillit, vizitën baritore dhe vizitën vëllazërore.

Neni 64

Kapitulli krahinor është organi përfaqësues i të gjitha Vëllazërive që ekzistojnë në brendësi të një Vëllazërie krahinore, me pushtet zgjedhës dhe vendimor.
Statutet kombëtare parashikojnë formalitetet e thirrjes, përbërjen, karakterin periodik dhe kompetencat.

Vëllazëria kombëtare

Neni 65

1. Vëllazëria kombëtare është bashkimi organik i Vëllazërive lokale që gjenden në territorin e një ose më shumë Shteteve, të lidhura e të koordinuara midis tyre nëpërmjet Vëllazërive të rrethit, atje ku ato ekzistojnë.
2. Është detyrë e Presidencës së CIOFS-së formimi i Vëllazërive të reja kombëtare, sipas kërkesës dhe në dialogim me Këshillat e Vëllazërive të interesuara. Të jenë të informuar Eprorët rregulltarë kompetentë, të cilëve do t'u kërkohet ndihmesa shpirtërore.
3. Vëllazëria kombëtare:
- është e gjallëruar dhe e drejtuar nga një Këshill dhe një Ministër;
- është e rregulluar nga Statuti përkatës;
- ka nje seli të veten.

Neni 66

1. Këshilli kombëtar është i përbërë sipas normave të Statutit kombëtar. Në gjirin e Këshillit kombëtar mund të ndërtohet një këshill ekzekutiv, me kompetenca të dhëna nga Statuti.

2. Këshilli kombëtar ka për detyrë:

a. të përgatisë kremtimin e Kapitullit kombëtar të zgjedhur, sipas Statutit përkatës;

b. të bëjë të njohur dhe të nxisë, në të gjithë brendësinë e Vëllazërisë kombëtare përkatëse, karakterin shpirtëror françeskan shekullar;

c. të vendosë programet e aktiviteteve vjetore në shkallë kombëtare;

d. të kërkojë, të sinjalizojë, të publikojë dhe të përhapë mjetet e nevojshme për formimin e Françeskanëve shekullarë;

e. të frymëzojë e koordinojë aktivitetet e Këshillave krahinore;

f. të ruajë lidhjen me Presidencën e CIOFS-së;

g. të zgjedhë përfaqësuesin e Vëllazërisë kombëtare në Këshillin ndërkombëtar dhe të marrë përsipër shpenzimet që ajo sjell;

h. të diskutojë e të miratojë raportin vjetor për Presidencën e CIOFS-së;

i. të kujdeset për praninë e UFSH-së në organizmat kishtare në nivel kombëtar;

l. të vendosë vizitën vëllazërore ndaj Këshillave të Vëllazërive krahinore e lokale, edhe pse nuk është kërkuar, por kur rrethanat e lypin;

m. të vendosë në saje të qëllimit të caktuar të fondeve të disponueshme dhe, në përgjithësi, për marrëdhëniet ekonomike të Vëllazërisë;

n. para mbarimit të mandatit të tij, të bëjë verifikimin nga një person ekspert, që të mos jetë anëtar i Këshillit, ose nga kolegji i revizorëve të llogarive të Vëllazërisë, të gjendjes financiare dhe pronat e Vëllazërisë kombëtare;

o. të përmbushë detyrat e tjera të përcaktuara nga Kushtetutat ose të nevojshme për të arritur qëllimet e veta.

Neni 67

1. Duke theksuar bashkëpërgjegjësinë e Këshillit në inkurajimin dhe drejtimin e Vëllazërisë kombëtare, i përket Ministrit, që është përgjegjësi i parë, të kujdeset që të vihen në zbatim orientimet dhe vendimet e Këshillit, që do ta informojë për veprimtarinë e tij.

2. Ministri kombëtar gjithashtu ka për detyrë:

a. të thërrasë e të kryesojë mbledhjet e Këshillit Kombëtar; të thërrasë çdo tre vjet Kapitullin kombëtar të zgjedhur, pasi të ketë dëgjuar Këshillin mbi formalitetin e mbledhjes, sipas Statutit kombëtar;

b. të drejtojë dhe koordinojë me Përgjegjësat kombëtarë aktivitetet vepruese në shkallë kombëtare;

c. të bëjë të ditur mbi jetën dhe mbi aktivitetet e UFSH-së të Vendit të tij në Këshill dhe në Kapitullin kombëtar;

d. të përfaqësojë Vëllazërinë kombëtare përpara autoriteteve kishtare dhe civile. Kur Vëllazëria kombëtare të ketë personalitet juridik civil i takon Ministrit përfaqësimi ligjor;
e. të kryesojë dhe të garantojë zgjedhjet e Këshillit krahinor, personalisht ose nëpërmjet një delegati anëtar i Këshillit kombëtar, por që të mos jetë Asistenti shpirtëror;
f. të kryejë vizitën vëllazërore në Këshillat krahinore, personalisht ose nëpërmjet një delegati, anëtar i Këshillit kombëtar;
g. të kërkojë, me lejen e Këshillit, vizitën vëllazërore dhe vizitën baritore të paktën një herë në çdo gjashtë vjet.

Neni 68

1. Kapitulli kombëtar është organ përfaqësues i Vëllazërive që gjenden në brendësi të një Vëllazërie kombëtare me pushtet ligjvënës, vendimor dhe zgjedhës. Mund të marrë vendime ligjvënëse dhe të shpallë norma, në përputhje me Rregullën dhe Kushtetutat, të vlefshme në shkallë kombëtare. Statutet kombëtare përcaktojnë strukturën, periodicitetin, kompetencat dhe mënyrën e thirrjes të Kapitullit kombëtar.
2. Statutet kombëtare mund të sodisin forma të tjera të mbledhjeve e të asambleve për të nxitur jetën dhe apostullimin në shkallë kombëtare.

Vëllazëria ndërkombëtare

Neni 69

1. Vëllazëria ndërkombëtare është e përbërë nga bashkimi organik i të gjitha Vëllazërive françeskane shekullare katolike të botës. Ajo identifikohet me njësimin e UFSH-së. Ka personalitet juridik të sajin në Kishë. Organizohet dhe vepron në përputhje me Kushtetutat dhe me Statutin përkatës.
2. Vëllazëria ndërkombëtare gjallërohet dhe drejtohet nga Këshilli Ndërkombëtar i UFSH-së (CIOFS-ja), me seli në Romë (Itali), nga Presidenca e saj dhe nga Ministri i Përgjithshëm ose Presidenti ndërkombëtar.

Neni 70

1. Këshilli Ndërkombëtar përbëhet nga anëtarët, të zgjedhur në përputhje me normat e Kushtetutave dhe të Statutit të tij:
-- vëllezërit që kanë bërë kushtet të UFSH-së;
-- përfaqësuesit e Rinisë Françeskane.
Bëjnë pjesë, gjithashtu, Këshilli ndërkombëtar i katër Asistentetëve të përgjithshëm.

2. Në gjirin e Këshillit ndërkombëtar ndërtohet Presidenca e CIOFS-së, që është pjesë përbërëse e tij.
3. Këshilli ndërkombëtar i mbledhur në Kapitullin e përgjithshëm është organi më i lartë i qeverisë së UFSH-së, me fuqi ligjvënëse, vendimore dhe zgjedhëse. Mund të marrë vendime ligjvënëse dhe të shpallë norma në përputhje me Rregullën dhe me Kushtetutat.
4. Këshilli ndërkombëtar mblidhet çdo gjashtë vjet në Kapitull të përgjithshëm të zgjedhur, dhe të paktën një herë midis dy Kapitujve të përgjithshëm të zgjedhur, sipas normave të vendosura nga Kushtetutat dhe nga Statuti ndërkombëtar.

Neni 71

1. Qëllime dhe detyra të Këshillit ndërkombëtar janë:

a. të nxisë dhe mbështesë jetën ungjillore sipas shpirtit të shën Françeskut të Asizit, në gjendjen shekullare të besimtarëve që jetojnë në të gjithë botën;

b. të forcojë ndjenjën e njësimit të UFSH-së duke respektuar pluralizmin e personave dhe të grupeve, për më tepër përforcon detyrimin e njësimit, të bashkëpunimit, të shpërndarjes ndërmjet Vëllazërive kombëtare;

c. të harmonizojë, sipas karakterit të origjinës të UFSH-së, traditat e shëndosha me ripërtëritjen në fushën teologjike, baritore e legjislative, në pikëpamjen e një formimi të përcaktuar ungjillor françeskan;

d. të ndihmojë, duke ndjekur traditën e UFSH-së, në përhapjen e ideve e të nismave që vlejnë për të ndihmuar gatishmërinë e françeskanëve shekullare në jetën e Kishës e të shoqërisë;

e. të përforcojë orientimet dhe të vendosë përparësitë për veprimet e Kryesisë së tij;

f. të interpretojë Kushtetutat përsa parashikohet në nenin 5, 2.

2. Statuti ndërkombëtar përcakton përbërjen e Këshillit ndërkombëtar dhe mënyrën e thirrjes së mbledhjeve të saj.

Neni 72

1. Kryesia e CIOFS-së përbëhet nga:

- Ministri i Përgjithshëm;
- Zëvendës Ministri;
- Këshilltarët e Kryesisë;
- një anëtar i Rinisë Françeskane;
- Asistentët e Përgjithshëm të UFSH-së.

2. Këshilltarët e Kryesisë zgjidhen në përputhje me normat e Statutit ndërkombëtar që përcakton numrin e zonave për të përfaqësuar.

Neni 73

Detyrimet dhe detyrat e Kryesisë së CIOFS-së janë:

a. të vërë në zbatim vendimet dhe orientimet e Kapitullit të Përgjithshëm;

b. të koordinojë, gjallërojë e të drejtojë UFSH-në në nivelin ndërkombëtar, për të bërë vepruese ndërvarësinë dhe ndërsjellshmërinë e UFSH-së në nivele të ndryshme të Vëllazërisë;

c. ndërhyn me shpirtin e shërbimit sipas rrethanave, për t'u çuar ndihmë vëllazërore në sqarimin dhe në zgjidhjen e problemeve të rënda e urgjente të UFSH-së, duke informuar Këshillin kombëtar të interesuar dhe Kapitullin e Përgjithshëm që vjen më pas;

d. përforcon, në nivel botëror, raportet e ndërsjella të bashkëpunimit ndërmjet UFSH-së dhe pjesëtarëve të tjerë të Familjes Françeskane;

e. organizon, në përputhje me Statutin ndërkombëtar, mbledhje ose asamble për të nxitur jetën dhe apostullimin e UFSH-së në shkallë ndërkombëtare;

f. bashkëpunon me Organizatat dhe Shoqatat që mbajnë lart të njëjtat vlera;

g. përmbush detyrat e tjera të përcaktuara nga Kushtetutat ose të nevojshme për të arritur qëllimet e veta.

Neni 74

1. Duke theksuar bashkëpërgjegjësinë e Kryesisë së CIOFS-së, i takon Ministrit të Përgjithshëm, që është përgjegjësi i parë, të kujdeset që të vihen në zbatim vendimet dhe orientimet e Kapitullit të Përgjithshëm dhe të Kryesisë, që do të informojë për veprimtarinë e tij.

2. Ministri i Përgjithshëm, gjithashtu, ka detyrën:

a. të thërrasë e të drejtojë mbledhjet e Kryesisë sipas Statutit përkatës;

b. të thërrasë, me lejen e Kryesisë, dhe të kryesojë mbledhjet e Kapitullit të Përgjithshëm;

c. të jetë shenjë e dukshme dhe reale e njësimit dhe e ndërsjellshmërisë jetësore midis UFSH-së dhe Ministrave të Përgjithshëm të Urdhrit të Parë Françeskan dhe të TOR-së, pranë të cilëve përfaqëson UFSH-në, dhe të kujdeset për lidhjen me Konferencën e Asistentave të Përgjithshëm;

d. të përfaqësojë UFSH-në në shkallë botërore përballë autoriteteve kishtare dhe civile. Kur Vëllazëria ndërkombëtare të ketë personalitet juridik civil, i takon Ministrit përfaqësia ligjore;

e. të kryejë vizitën vëllazërore në Këshillat kombëtare personalisht ose me anë të një të deleguari që është anëtar i CIOFS-së;

f. të kryesojë e të ripohojë zgjedhjet e Këshillave kombëtare personalisht ose nëpërmjet një delegati;

g. të kërkojë, me lejen e Kryesisë, vizitën baritore në Konferencën e Ministrave të Përgjithshëm të Urdhrit të Parë e të TOR-së;
h. të ndërhyjë në rastet urgjente, duke informuar Kryesinë;
i. të firmosë dokumentat zyrtare të Vëllazërisë ndërkombëtare;
l. të ushtrojë, me lejen e Kryesisë dhe së bashku me një Këshilltar tjetër të Kryesisë, i caktuar nga po ajo, të drejtat e pronës përkatëse të Vëllazërisë ndërkombëtare.
m. para çdo Kapitulli të Përgjithshëm, të bëjë verifikimin e gjendjes financiare dhe pronat e Vëllazërisë ndërkombëtare nga një llogaritar i kualifikuar, të mos jetë i përzier në administrimin ekonomik e financiar të Kryesisë.

Neni 75

Detyrat e veçanta të Këshilltarëve ndërkombëtarë janë të përcaktuara nga Statuti ndërkombëtar.

Titulli IV

EMËRIMI DHE PUSHIMI NGA DETYRAT

Zgjedhjet

Neni 76

1. Zgjedhjet në nivele të ndryshme do të mbahen në përputhje me normat e së Drejtës së Kishës e të Kushtetutave. Thirrja le të bëhet të paktën një muaj përpara, duke përcaktuar vendin, ditën dhe orën e zgjedhjes.
2. Asamblea zgjedhëse, ose Kapitulli, do të jetë i kryesuar nga Ministri i nivelit të menjëhershëm më të lartë ose nga një i deleguar i tij, i cili miraton zgjedhjen.
Ministri ose i deleguari nuk mund të kryesojë zgjedhjet në Vëllazërinë lokale përkatëse dhe as në zgjedhjet e Këshillit të një niveli tjetër, në të cilën është anëtar.
Të jetë i pranishëm Asistenti shpirtëror i nivelit të menjëhershëm më të lartë ose një i deleguar i tij, si dëshmimtar i njësimit me Urdhrin e Parë e me TOR-në.
Një përfaqësues i Konferencës së Ministrave të Përgjithshëm të Urdhrit të Parë e të TOR-së kryeson dhe miraton zgjedhjet e Kryesisë së CIOFS-së.

3. Kryesuesi i Kapitullit dhe Asistenti i nivelit më të lartë nuk kanë të drejtën e votës.
4. Kryesuesi i Kapitullit cakton, midis anëtarëve të Kapitullit, një sekretar dhe dy vëzhgues.

Neni 77

1. Në Vëllazërinë lokale kanë zë aktiv, domethënë mund të zgjedhin, dhe zë pasiv, domethënë mund të zgjidhen, rregulltarët e përhershëm të po vetë Vëllazërisë. Kanë zë vetëm aktiv rregulltarët e përkohshëm.
2. Në nivelet e tjera kanë zë aktiv: anëtarët shekullarë të Këshillit që po mbaron, përfaqësuesit e nivelit që vijon menjëherë më poshtë dhe të Rinisë Françeskane, nëse janë rregulltarë. U përket Statuteve të veçanta të vendosin norma më konkrete për vënien në zbatim të normave të mëparshme, duke pasur kujdes për të siguruar bazën zgjedhëse sa më të madhe. Kanë zë pasiv françeskanët shekullarë rregulltarë të përhershëm të zonës përkatëse.
3. Statutet kombëtare dhe ato ndërkombëtare, secila duke respektuar zonën përkatëse, mund të vendosin cilësi të nevojshme objektive që të mund të zgjidhen në disa detyra.
4. Për vazhdimin në mënyrë të vlefshme në kremtimin e Kapitullit të zgjedhur, kërkohet prania të paktën e më shumë se gjysma e atyre që ka të drejtën e votës.

Neni 78

1. Për zgjedhjet e Ministrit kërkohet shumica absolute e votave e të pranishmëve, të shprehura në mënyre sekrete. Pas dy shqyrtimeve të paefektshme vazhdohet për votimin e dytë midis dy kandidatëve që kanë fituar numrin më të madh të votave ose, në qoftë se janë më shumë se dy, midis dy kandidatëve më të moshuar të Kushteve; pas shqyrtimit të tretë, në qoftë se mbetet gjithnjë në barazim, të quhet i zgjedhur kush është më i moshuari në Kushte.
2. Për zgjedhjen e Zëvendës Ministrit të veprohet në të njëjtën mënyrë.
3. Për zgjedhjen e Këshilltarëve, pas shqyrtimit të parë pa shumicën absolute, në shqyrtimin e dytë është e mjaftueshme shumica relative e votave të të pranishmëve, të shprehur në mënyrë sekrete, me përjashtim kur Statutet e veçanta kërkojnë një shumicë më të madhe.
4. Sekretari deklaron rezultatin e zgjedhjeve; Kryesuesi, në qoftë se gjithçka është zhvilluar në rregull dhe të zgjedhurit kanë pranuar detyrën, miraton zgjedhjen sipas Ritualit.

Neni 79

1. Ministri dhe Zëvendës Ministri mund të zgjidhen për dy trevjeçarë rresht. Për të tretën dhe të fundit zgjedhje rresht në detyrën e Ministrit dhe të Zëvendës Ministrit do

të jetë e nevojshme shumica e 2/3 e votave të të pranishmëve, që duhet të fitohet që me shqyrtimin e parë.
2. Ministri që po ikën nuk mund të zgjidhet Zëvendës Ministër.
3. Këshilltarët mund të zgjidhen për disa trevjeçarë rresht. Duke u nisur nga zgjedhja e tretë që vjen pas, do të jetë e nevojshme shumica e 2/3 të votave të të pranishmëve, që duhet të fitohet që në shqyrtimin e parë.
4. Ministri i Përgjithshëm, Zëvendës Ministri dhe Këshilltarët e Kryesisë, mund të zgjidhen vetëm për dy gjashtëvjeçarë rresht.
5. Këshilli i nivelit më të lartë ka të drejtën-detyrën të shfuqizojë zgjedhjet e t'i mbledhë përsëri në të gjitha rastet e shkeljes së normave të lartpërmendura.

Neni 80

Statutet e veçanta mund të përmbajnë në lëndën e zgjedhjeve udhëzime të mëtejshme të zbatueshme, me kusht që të mos jenë në kundërshtim me Kushtetutat.

Postet vakante

Neni 81

1. Kur detyra e Ministrit mbetet vakant në rast vdekjeje, mospranimi ose një pengesë tjetër e karakterit përfundimtar, Zëvendës Ministri merr përsipër detyrën deri në përfundimin e mandatit për të cilën Ministri fillimisht ishte i zgjedhur.
2. Me t'u bërë vakante detyra e Zëvendës Ministrit, njëri nga Këshilltarët zgjidhet Zëvendës Ministër nga Këshilli i Vëllazërisë, me vlerë deri në Kapitullin zgjedhës.
3. Me t'u bërë vakante detyra e Këshilltarit, Këshilli do të veprojë për zëvendësimin e tij në përputhje me Statutet përkatëse, me vlerë deri në Kapitullin zgjedhës.

Detyrat e papajtueshme

Neni 82

Janë të papajtueshme:

a. detyra e Ministrit në dy nivele të ndryshme;

b. detyrat e Ministrit, Zëvendës Ministrit, Sekretarit dhe Përgjegjësit të Thesarit në të njëjtin nivel.

Mospranimi ndaj detyrës

Neni 83

1. Mospranimi në Kapitull i Ministrit të çfarëdo niveli të pranohet nga vetë Kapitulli. Mospranimi i Ministrit, jashtë Kapitullit, paraqitet në Këshill. Pranimi i mospranimit duhet të jetë i ripohuar nga Ministri i nivelit më të lartë dhe, për Ministrin e Përgjithshëm, nga Konferenca e Ministrave të Përgjithshëm të Urdhrit të Parë e të TOR-së.
2. Mospranimi ndaj detyrave të tjera i paraqitet Ministrit dhe Këshillit të tij, të cilit i përket pranimi i mospranimit.

Heqja

Neni 84

1. Në rastin e moskryerjes së detyrave përkatëse nga ana e Ministrit, Këshilli i interesuar shfaq shqetësimin e tij në dialog vëllazëror me të. Nëse nuk vjen një rezultat pozitiv, Këshilli njofton Këshillin e nivelit më të lartë, të cilit i përket të shqyrtojë rastin dhe, nëse nevojitet, me anën e votimit të fshehur, të vendosë heqjen e Ministrit.
2. Për shkak të rëndë, publik e të vërtetuar, Këshilli i nivelit më të lartë, pas një dialogu vëllazëror me të interesuarin, mundet, nëpërmjet e votës së fshehtë, të vendosë heqjen e një Ministri të nivelit më poshtë.
3. Heqja nga detyrat e tjera të Këshillit, kur të jetë shkak i rëndë, i përket Këshillit në të cilin bëjnë pjesë, e vendosur nëpërmjet votës së fshehtë, pas një dialogu vëllazëror me të interesuarin.
4. Kundër heqjes mund të ndërmjetësojë kërkesa e ndërprerjes ndaj Këshillit të nivelit menjeherë më të lartë nga ai që ka urdhëruar masën ndëshkimore, me afatin e vlefshëm për 30 ditë.
5. Heqja e Ministrit të Përgjithshëm është nën kompetencën e Konferencës së Ministrave të Përgjithshëm të Urdhrit të Parë e të TOR-së.
6. Një Këshill i nivelit më të lartë, në rastin e mosplotësimeve të rënda ose të parregullsive nga ana e Ministrit ose e një Këshilli, do të vendosë vizitën vëllazërore të Këshillit të interesuar dhe po qe nevoja do të shpejtojë vizitën baritore. Do të vlerësojë, me mirësi dhe kujdes, gjendjen e vërtetuar dhe do të vendosë masat më të përshtatshme për rastin, përfshirë dhe heqjen e mundshme të Këshillit ose të Përgjegjësve të interesuar.

Titulli V

NDIHMESA SHPIRTËRORE DHE BARITORE

E UFSH-së

Neni 85

1. Si pjesë përbërëse e Familjes Françeskane dhe e thirrur për të jetuar karizmën e Françeskut në përmasat e tij shekullare, UFSH-ja ka lidhje të veçanta, të ngushta me Urdhrin e Parë dhe me TOR-në.

2. Kujdesi shpirtëror dhe baritor i UFSH-së, që Kisha ia ka besuar Urdhrit të Parë Françeskan dhe TOR-së, është detyrë mbi të gjitha e Ministrave të Përgjithshëm dhe Provincialë të tyre. Këtyre u përket "l'altius moderamen" në lidhje me kan. 303. "L'altius moderamen" synon të garantojë besnikërinë e UFSH-së ndaj karizmës françeskane, bashkësinë me Kishën dhe njësimin me Familjen Françeskane, vlera që për françeskanët shekullarë përfaqësojnë një angazhim të jetës.

Neni 86

1. Ministrat e Përgjithshëm dhe Provincialët ushtrojnë detyrën e tyre për sa i përket UFSH-së nëpërmjet:

- ngritjes së Vëllazërive lokale;
- vizitës baritore;
- ndihmesës shpirtërore në Vëllazëritë e niveleve të ndryshme.

Mund të ushtrojnë këtë detyrë personalisht ose nëpërmjet një të deleguari.

2. Ky shërbim i Ministrave rregulltarë plotëson, por nuk zëvendëson atë të Këshillit dhe të Ministrave shekullarë, të cilëve u përket drejtimi, koordinimi dhe gjallërimi i Vëllazërive në nivele të ndryshme.

Neni 87

1. Për gjithçka që i përket në tërësi UFSH-së, "l'altius moderamen" duhet të ushtrohet nga Ministrat e Përgjithshëm në mënyrë kolegjiale.

2. I takon në veçanti Konferencës së Ministrave të Përgjithshëm të Urdhrit të Parë e të TOR-së:

- të kujdeset për raportet me Selinë e Shenjtë për sa i përket miratimit të dokumentave legjislativë ose liturgjikë, miratimi i të cilave të jetë kompetencë e Selisë së Shenjtë;
- të vizitojë Kryesinë e CIOFS-së;
- të ripohojë zgjedhjen e Kryesisë së CIOFS-së.

3. Secili nga Ministrat e Përgjithshëm, në zonën e Urdhrit të tij, të kurojë interesimin e rregulltarëve dhe përgatitjen e tyre për shërbimin në UFSH, sipas Kushtetutave përkatëse dhe Kushtetutave të UFSH-së.

Neni 88

1. Ministrat Provincialë dhe të tjerë Eprorë madhorë, në zonën e kompetencave të veta, sigurojnë ndihmën shpirtërore në Vëllazëritë lokale të dhëna në besim nga juridiksioni. Kujdesen per interesimin e rregulltarëve të tyre në UFSH dhe përkujdesen që të zgjidhen persona të aftë e të përgatitur në detyrën e ndihmesës shpirtërore.

2. U përket veçanërisht Eprorëve madhorë, në emër të juridiksionit të tyre përkatës:

a. ngritja sipas Drejtësisë Kanonike e Vëllazërive të reja lokale, duke iu siguruar atyre ndihmesën shpirtërore;

b. gjallërimi shpirtëror dhe vizita në Vëllazëritë lokale të ndihmuara nga juridiksioni i tyre;

c. të mbahen të informuar mbi ndihmesën shpirtërore të dhënë në UFSH.

Neni 89

1. Në bazë të ndërsjellshmërisë jetësore midis rregulltarëve e shekullarëve të Familjes Françeskane dhe të përgjegjësive të Eprorëve madhorë, në Vëllazëritë e UFSH-së në të gjitha nivelet duhet të jetë e siguruar ndihmesa shpirtërore si element themelor i njësimit.

2. Asistenti shpirtëror është personi i caktuar nga Eprori madhor kompetent për të kryer këtë shërbim ndaj një Vëllazërie të përcaktuar të UFSH-së.

3. Që të jetë dëshmitar i karakterit shpirtëror françeskan e i përzemërsisë vëllazërore i rregulltarëve ndaj françeskanëve shekullare dhe lidhje bashkimi[17] midis Urdhrit dhe UFSH-së, Asistenti shpirtëror të jetë një rregulltar françeskan, pjesëtar i Urdhrit të Parë ose të TOR-së.

4. Kur nuk është e mundshme për t'i dhënë Vëllazërisë një Asistent shpirtëror të tillë, Eprori madhor kompetent mund t'ua besojë shërbimin e ndihmesës shpirtërore:

a. rregulltarëve ose rregulltareve që janë anëtarë të Instituteve të tjera françeskane;

b. priftërinjve dioqezanë ose personave të tjerë, veçanërisht të përgatitur për këtë shërbim, pjesëmarrës në UFSH;

c. priftërinj të tjerë dioqezanë ose rregulltarë jo françeskanë.

5. Autorizimi paraprak i Eprorit ose i Ordinarit të vendit, kur nevojitet, nuk heq përgjegjësinë e Eprorit madhor françeskan për cilësinë e shërbimit baritor dhe të ndihmesës shpirtërore.

Neni 90

1. Është detyrë kryesore e Asistentit të komunikojë karakterin shpirtëror françeskan dhe të bashkëpunojë në formimin fillestar dhe të përhershëm të vëllezërve.

2. Asistenti shpirtëror është anëtar që i përket me të drejtë, me votë, i Këshillit të Vëllazërisë, në të cilën jep ndihmesën dhe bashkëpunon me të në të gjitha aktivitetet. Nuk ushtron të drejtën e votës në çështjet ekonomike.

3. Veçanërisht:

a. Asistentët e Përgjithshëm japin shërbimin e tyre në Kryesinë e CIOFS-së, formojnë Konferencën dhe kujdesen kolegjialisht për ndihmesën shpirtërore në UFSH në të gjitha pjesët e saj;

b. Asistentët kombëtarë japin shërbimin e tyre në Këshillin kombëtar dhe kujdesen për ndihmesën shpirtërore të UFSH-së në të gjithë territorin e Vëllazërisë kombëtare dhe koordinimin, në shkallë kombëtare, të Asistentëve krahinorë. Nëse janë më shumë se një, formojnë një Konferencë dhe bëjnë shërbimin në mënyrë kolegjiale;

c. Asistentët krahinorë japin shërbimin e tyre në Këshillin krahinor dhe kujdesen për ndihmesën shpirtërore në Vëllazërinë krahinore. Nëse janë më shumë se një, formojnë një Konferencë dhe bëjnë shërbimin në mënyrë kolegjiale;

d. Asistentët lokalë japin shërbimin e tyre në Vëllazëritë lokale dhe në Këshillin e tij.

Neni 91

1. Këshilli i Vëllazërisë i çdo niveli kërkon Asistentë të aftë dhe të përgatitur në kompetencat Eprore të Urdhrit të Parë e të TOR-së.

2. Veçanërisht:

a. Kryesia e CIOFS-së i kërkon Asistentin e Përgjithshëm Ministrit të Përgjithshëm përkatës;

b. Këshilli kombëtar i kërkon Asistentin kombëtar Eprorit madhor, i treguar në mënyre kolegjiale nga Eproret Madhorë me kompetencë në territorin e Vëllazërisë kombëtare;

c. Këshilli krahinor i kërkon Asistentin Eprorit madhor, i treguar në mënyrë kolegjiale nga Eprorët madhorë me kompetencë në territorin e Vëllazërisë krahinore;

d. Këshilli lokal i kërkon Asistentin Eprorit madhor të kompetencës përkatëse që ka përgjegjësinë për ndihmesën.

3. Eprori madhor kompetent, pasi ka dëgjuar Këshillin e Vëllazërisë së interesuar, emëron Asistentin në përputhje me normat e Kushtetutave të pranishme dhe të *Statutit për ndihmesën shpirtërore dhe baritore në Urdhrin Françeskan Shekullar*.

Titulli VI

VIZITA VËLLAZËRORE DHE VIZITA BARITORE

Neni 92

1. Qëllimi i vizitës qoftë vëllazërore dhe baritore, është ajo për të gjallëruar shpirtin ungjillor françeskan, të sigurojë besnikërinë ndaj karizmës dhe ndaj Rregullës, të japë ndihmë në jetën e vëllazërisë, të riforcojë lidhjen e njësimit të Urdhrit dhe të nxisë përfshirjen e tij sa më të efektshme në Familjen françeskane dhe në Kishë (krh. *Rreg. 26*).

2. Kërkesat e vizitës, si vëllazërore dhe baritore, bëhen, me lejen e Këshillit përkatës:

a. nga Ministri i Vëllazërise lokale e krahinore, të paktën çdo tre vjet, në Këshillin që është menjëherë më i lartë në Konferencën përkatëse të Asistentëve shpirtërorë;

b. nga Ministri kombëtar, të paktën çdo gjashtë vjet, ndaj Presidencës së CIOFS-së dhe ndaj Konferencës së Asistentëve të Përgjithshëm;

c. nga Ministri i Përgjithshëm, të paktën çdo gjashtë vjet, ndaj Konferencës së Ministrave të Përgjithshëm.

3. Për shkaqe urgjente dhe të rënda, ose në rast të mospërmbushjes së kryerjes së kërkesës nga ana e Ministrit dhe të Këshillit, vizita vëllazërore dhe baritore mund të kryhen me nismën e Këshillit dhe të Konferencës së Asistentëve shpirtërorë, që përkatësisht janë kompetentë.

Neni 93

1. Në vizitat ndaj Vëllazërive lokale dhe ndaj Këshillave në nivele të ndryshme, vizituesi do të verifikojë jetëgjatësinë ungjillore dhe apostolike, zbatimin e Rregullës dhe të Kushtetutave, përfshirjen e Vëllazërive në Urdhër dhe në Kishë.

2. Në vizitat ndaj Vëllazërive lokale dhe në Këshillat e niveleve të ndryshme, Vizituesi do t'i njoftojë në kohën e duhur Këshillit të interesuar temën dhe programin e vizitës. Do të marrë në shqyrtim regjistrat dhe dokumentat e akteve, duke përfshirë edhe ato që u përkasin vizitave të mëparshme, zgjedhjes së Këshillit dhe të administrimit të pronave.

Do të përgatisë një relacion të vizitës së kryer, duke shënuar tek aktet në regjistrin e posaçëm të Vëllazërisë së vizituar dhe do ta dërgojë që ta njohë Këshilli i nivelit që ka kryer vizitën.

3. Në vizitën ndaj Vëllazërisë lokale, Vizituesi do të takohet me të gjithë Vëllazërinë dhe me grupet e seksionet nga të cilat ajo përbëhet. Kujdes të veçantë do t'u japë vëllezërve në formim dhe atyre vëllezërve që do të duan të kërkojnë një takim

personal. Do të vazhdojë, në qoftë se do të kërkohet, me korrigjimin vëllazëror të mangësive në qoftë se do të zbulohen.
4. Dy Vizituesit, shekullarë e rregulltarë, munden, nëse kjo ndihmon në shërbimin e Vëllazërisë, të kryejnë njëkohësisht vizitën, duke përkuar paraprakisht programin në mënyrë sa më përputhëse me misionin e secilit prej tyre.
5. Vizita vëllazërore e baritore, e kryer nga niveli që vijon menjëherë më lart, nuk pengon që Vëllazëria e vizituar të mbajë të drejtën për t'iu drejtuar Këshillit ose Konferencës së Asistentëve shpirtërorë të më të lartit nivel.

Vizita vëllazërore

Neni 94

1. Vizita vëllazërore është një çast i bashkimit, shprehje e shërbimit dhe e interesimit real të Përgjegjësve shekullarë në disa nivele për arsye që vëllazëria të rritet e të jetë besnike ndaj thirrjes së saj.
2. Ndërmjet nismave të reja për të përmbushur qëllimin e vizitës, Vizituesi do të kushtojë vëmendje të veçantë:

- ndaj vlerës së formimit, fillestar dhe të përhershëm;
- ndaj raporteve të mbajtura me Vëllazëritë e tjera në nivele të ndryshme, me të rinjtë françeskanë dhe me të gjithë Familjen Françeskane;
- ndaj zbatimit të udhëzimeve dhe orientimeve të CIOFS-së e të Këshillave të tjerë;
- ndaj pranisë në Kishën lokale.

3. Vizituesi do të marrë në shqyrtim llogarinë e verifikimit të mëparshëm mbi administrimin financiar dhe pronësor të Këshillit, do të kontrollojë regjistrin e arkës dhe çdo dokument që ka lidhje me situatën e pronësisë të Vëllazërisë dhe kushtin e mundshëm të personit juridik në sistemin civil, po aty të përfshira dhe aspektet tatimore. Në mangësinë e verifikimit të duhur mbi administrimin financiar dhe pronësor të Këshillit, Vizituesi do të mundë, me shpenzimet e Vëllazërisë së vizituar, të porosisë këtë verifikim nga një person ekspert që nuk është anëtar i Këshillit të interesuar. Në qoftë se e quan të përshtatshme, për këto aspekte, Vizituesi do të bëjë të mundur për t'u ndihmuar nga personi kompetent.
4. Vizituesi do të kontrollojë dokumentat e akteve të zgjedhjes së Këshillit, do të vlerësojë cilësinë e shërbimit të dhënë ndaj Vëllazërisë nga Ministri e nga Përgjegjësat e tjerë dhe do të studiojë me ata zgjidhjen e problemeve të mundshme. Në rast se do të ketë zbuluar që, për çfarëdo arsyeje, shërbimi i tyre nuk është zhvilluar në mënyrën e duhur me kërkesat e Vëllazërisë, Vizituesi do të nxisë nismat e duhura, duke mbajtur parasysh, rrethanat e veçanta, siç disponohet mbi mospranimin dhe heqjen nga detyrat.

5. Vizituesi nuk mund të kryejë vizitën në Vëllazërinë lokale të tijën dhe as në Këshillin e një niveli tjetër, në të cilin ai është anëtar.

Vizita baritore

Neni 95

1. Vizita baritore është një moment i privilegjuar i bashkësisë me Urdhrin e Parë dhe me TOR-[-]në. Ajo kryhet edhe në emër të Kishës dhe shërben për të garantuar e nxitur respektimin e Rregullës e të Kushtetutave dhe besnikërinë ndaj karizmës françeskane. Do të zhvillohet me respektimin e organizimit dhe sipas të drejtës përkatëse të UFSH-[-]së.

2. Vizituesi, pasi ka verifikuar ngritjen e kanonikës së Vëllazërisë, do të interesohet për raportet midis Vëllazërisë e Asistentit të saj shpirtëror dhe Kishës lokale, dhe do të takojë priftërinjtë (ipeshkvin, famullitarin), kur kjo të jetë e mundshme për të inkurajuar bashkimin dhe shërbimin në ndërtimin e Kishës.

3. Do të nxisë bashkëpunimin dhe ndjenjën e bashkëpërgjegjësisë midis Përgjegjësve shekullarë dhe Asistentëve shpirtërorë. Do t'i duhet të kontrollojë cilësinë e ndihmesës shpirtërore që i jepet Vëllazërisë së vizituar, të inkurajojë Asistentët shpirtërorë në shërbimin e tyre dhe të nxisë formimin shpirtëror dhe baritor të përhershëm të tyre.

4. Do të kushtojë vëmendje të veçantë ndaj programeve, metodave dhe përvojave formuese, ndaj jetës liturgjike e lutjes dhe ndaj aktiviteteve apostolike të Vëllazërisë.

Titulli VII

RINIA FRANÇESKANE

Neni 96

1. UFSH-[-]ja, duke u bazuar në forcën e vetë thirrjes së saj, duhet të jetë e gatshme të përfshijë në përvojën e saj të jetës ungjillore të rinjtë që ndihen të tërhequr nga shën Françesku i Asizit dhe të kërkojë mjetet për t'ia paraqitur atyre në mënyrë të përshtatshme.

2. Rinia Françeskane (Rifra)[18], siç është e kuptuar nga këto Kushtetuta dhe për të cilën UFSH-[-]ja në mënyrë të veçantë quhet përgjegjëse, është e formuar nga ata të rinj që ndihen të thirrur nga Shpirti Shenjt për të bërë në Vëllazëri përvojën e jetës së krishterë, nën ndriçimin e mesazhit të shën Françeskut të Asizit, duke thelluar thirrjen e vet në ambientin e Urdhrit Françeskan Shekullar.

3. Anëtarët e Rifra marrin parasysh Rregullën e UFSH-së si dokument i frymëzimit për rritjen e thirrjes së tyre të krishterë dhe françeskane, si në mënyrë personale ashtu dhe në grup. Pas një periudhe të mjaftueshme të formimit, të paktën për një vit, të përforcojnë këtë zgjedhje me një angazhim vetjak përpara Zotit dhe në praninë e vëllezërve.
4. Anëtarët e Rifra-së, që dëshirojnë të marrin pjesë në UFSH, t'i përmbahen asaj që parashikohet në Rregullën, në Kushtetutat dhe në Ritualin e UFSH-së.
5. Rifra ka një organizim të posaçëm dhe metoda të formimit dhe pedagogjike të përshtatshme me nevojat e botës rinore, sipas realiteteve ekzistuese në vende të ndryshme. Statuti kombëtar i Rifra duhet të miratohet nga Këshilli kombëtar përkates i UFSH-së ose, në mungesë të tij, nga Kryesia e CIOFS-së.
6. Rifra, si pjesë përbërëse e Familjes Françeskane, kërkon nga Përgjegjësat shekullarë dhe Eprorët rregulltarë kompetentë, përkatësisht, gjallërim vëllazëror dhe ndihmesë shpirtërore.

Neni 97

1. Vëllazëritë e UFSH-së, nëpërmjet nismave e dinamikave të përshtatshme, të nxisin thirrjen rinore françeskane. Të kujdesen për jetën dhe zgjerimin e Vëllazërive të Rifra-së dhe të shoqërojnë të rinjtë në udhëtimin e tyre të rritjes si njerëzore ashtu dhe shpirtërore me propozime për aktivitete e permbajte tematike.
2. Vëllazëritë e UFSH-së të angazhohen për t'u dhënë Vëllazërive të Rifra-së një gjallërim vëllazëror, që së bashku me Asistentin shpirtëror dhe Këshillin e Rifra-së, të sigurojë një formim françeskan shekullar të përshtatshëm.
3. Për të nxitur një bashkim të lidhur fort me UFSH-në, të gjithë Përgjegjësat e Rifra-së, në shkallë ndërkombëtare, dhe të paktën dy anëntarë të Këshillit kombëtar të Rifra-së, të jenë të rinj françeskanë shekullarë me kushte.
4. Një përfaqësues i Rifra-së., i caktuar nga Këshilli i tij për të bërë pjesë në Këshillin përkatës të UFSH-së në nivele të ndryshme; një përfaqësues i UFSH-së, i caktuar nga vetë Këshilli, bën pjesë në Këshillin e Rifra-së., që gjendet në të njëjtin nivel. Përfaqësuesi i Rifra-së, ka votë në Këshillin e UFSH-së vetëm nëse është françeskan shekullar me kushte.
5. Përfaqësuesit e Rifra-së., në Këshillin ndërkombëtar të UFSH-së zgjidhen në përputhje me Statutet ndërkombëtare që përcakton dhe numrin, Vëllazëritë për të përfaqësuar dhe kompetencat.

Titulli VIII

NË BASHKËSI ME FAMILJEN FRANÇESKANE DHE ME KISHËN

Neni 98

1. Françeskanët shekullarë të përpiqen për të jetuar në "bashkësi jetësore të ndërsjellë" me të gjithë anëtarët e Familjes Françeskane. Të jenë të gatshëm për të nxitur nismat e përbashkëta, ose për të marrë pjesë, me rregulltarët dhe rregulltaret e të Parit, e të Dytit dhe të të Tretit Urdhër, me Institutet Shekullare dhe me grupet e tjera kishtare laike që njohin shën Françeskun si shembull dhe frymëzues, për të bashkëpunuar në përhapjen e Ungjillit, për të hequr shkaqet e mënjanimit dhe për t'i shërbyer qëllimit të paqes (krh. *Rreg.* 1).
2. Veçanërisht duhet të kultivojnë dashurinë, që shprehet me nisma reale të bashkimit vëllazëror, ndaj motrave të jetës së soditjes mistike[19] që, si shenjtja Kjara e Asizit, japin dëshmi në Kishë e në botë dhe nga kjo ndërmjetësi presin bollëk lutjesh për Vëllazërinë dhe për veprat e apostullimit.

Neni 99

1. Si pjesë e gjallë e Popullit të Zotit, dhe duke u frymëzuar nga Ati Serafik, shekullarët françeskanë, "të njësuar në bashkim të plotë me papën dhe me ipeshkvinjtë", të përpiqen që të njohin dhe të thellojnë doktrinën e propozuar nga Magjisteri i Kishës nëpërmjet dokumenteve të saj sa më domethënëse dhe të jenë të vëmendshëm ndaj pranisë së Shpirtit Shenjt që gjallëron fenë dhe mirësinë e Popullit të Hyjit. Të bashkëpunojnë ndaj nismave të promovuara nga Selia e Shenjtë, veçanërisht në ato fusha në të cilat janë thirrur për të punuar për shkak të thirrjes françeskane shekullare (krh. *Rreg. 6*).
2. UFSH-ja, si shoqatë publike ndërkombëtare, është e lidhur me një lidhje të veçantë me Papën e Romës, nga i cili ka marrë miratimin e Rregullës dhe ripohimin e misionit të saj në Kishë dhe në botë.

Neni 100

1. Thirrja për të "rindërtuar" Kishën duhet të shtyjë vëllezërit për të dashur dhe jetuar sinqerisht bashkimin me Kishën lokale, në të cilën zhvillojnë thirrjen përkatëse dhe përmbushin angazhimin e tyre apostolik, të vetëdijshëm që në dioqezë është vepruese Kisha e Krishtit.
2. Françeskanët shekullarë përmbushin me devotshmëri detyrat të cilat i kanë marrë në lidhje me Kishën lokale; të japin ndihmë në aktivitetet e apostullimit dhe në aktivitetet shoqërore ekzistuese në dioqezë. Duke u bazuar në frymën e shërbimit të bëhen të

pranishëm si Vëllazëri, UFSH-ja në jetën e dioqezës, të gatshëm për të bashkëpunuar me grupet e tjera kishtare dhe për të marrë pjesë në Këshillat baritore.
3. Besnikëria ndaj karizmës përkatëse, françeskane dhe shekullare, dhe dëshmia e vëllazërisë së sinqertë dhe të çiltër, janë shërbimi i tyre kryesor ndaj Kishës, e cila është bashkësi dashurie. Të shquhen në të për "qenien" e tyre nga e cila rrjedh misioni i tyre.

Neni 101

1. Françeskanët shekullarë të bashkëpunojnë me ipeshkevijtë dhe të ndjekin orientimet për sa u takon si drejtuesa të misionit të Fjalës e të Liturgjisë dhe si koordinatorë të formave të ndryshme të apostullimit në Kishën lokale.
2. Vëllazëritë i nënshtrohen kontrollit të Ordinarit për sa ushtrojnë veprimin e tyre në Kishat lokale.

Neni 102

1. Vëllazëritë e ngritura në një Kishë famullitare të kërkojnë që të bashkëpunojnë në gjallërimin e bashkësisë famullitare, të liturgjisë e të marrëdhënieve vëllazërore; të integrohen në baritoren e së bashku me preferimin për aktivitetet më të përshtatshme ndaj traditës dhe karakterit shpirtëror françeskan shekullar.
2. Në famullitë që u janë besuar rregulltarëve françeskanë, Vëllazëritë përbëjnë, në ushtrimin e një ndërsjellshmërie të bollshme jetësore, ndërmjetësinë dhe dëshminë shekullare të karizmës Françeskane në bashkësinë famullitare. Kështu, të njësuar me rregulltarët, përkujdesen për përhapjen e mesazhit ungjillor dhe të mënyrës së jetës françeskane.

Neni 103

1. Duke qëndruar besnikë ndaj identitetit përkatës, Vëllazëritë do të kenë kujdes të vlerësojnë çdo rrethanë të lutjes, të formimit e të bashkëpunimit veprues me grupet e tjera kishtare. Të mirëpresin me kënaqësi ata që, pa marrë pjesë në UFSH, duan të bashkëndajnë përvojat dhe aktivitetet.
2. Vëllazëritë nxisin, ku të jetë e mundur, marrëdhënie vëllazërore me shoqata jo katolike, që marrin frymëzim nga Françesku.

TREGUESI I PËRGJITHSHËM

Dekreti i miratimit **3**
Dorëzimi i Kushtetutave të Përgjithshme **4**
Shpallja e Kushtetutave të Përgjithshme 5
Kushtetutat e Përgjithshme të Urdhrit Françeskan Shekullar **8**
Kapitulli i parë: Urdhri Françeskan Shekullar **8**
Kapitulli i dytë: Forma e jetës dhe Aktiviteti Apostolik **10**
Titulli I: Forma e jetës 10
Titulli II: Prania aktive në Kishë dhe në Botë 14
Për një shoqëri të drejtë e vëllazërore 14
Në familje 16
Lajmëtarë gëzimi dhe shprese 17
Kapitulli i tretë: Jeta në Vëllazëri **18**
Titulli I: Orientimet e përgjithshme 18
Titulli II: Hyrja në Urdhër dhe formimi 21
Periudha e fillimit 21
Pranimi në Urdhër 22
Periudha e formimit 22
Kushtet ose Premtimi i jetës ungjillore 22
Formimi i përhershëm 23
Kujdesja për thirrjen 24
Titulli III: Vëllazëria në nivele të ndryshme 24
Vëllazëria lokale 24
Këshilli i Vëllazërisë 25
Detyrat në Vëllazëri 26
Pjesëmarrja në jetën e Vëllazërisë 27
Transferimi 28
Masat e përkohshme 29
Masat përfundimtare 29
Vëllazëria krahinore 30
Vëllazëria kombëtare 31
Vëllazëria ndërkombëtare 34
Titulli IV: Emërimi dhe pushimi nga detyrat 37
Zgjedhjet 37
Postet vakante 38
Detyrat e papajtueshme 39
Mospranimi ndaj detyrës 39
Heqja 39

Titulli V: Ndihmesa shpirtërore dhe baritore e UFSH-së 40
Titulli VI: Vizita vëllazërore dhe Vizita baritore 43
Vizita vëllazërore 44
Vizita baritore 45
Titulli VII: Rinia Françeskane 45
Titulli VIII: Në bashkësi me Familjen Françeskane dhe me Kishën 46
Treguesi i përgjithshëm 49